



**FORCIMI I CILËSISË DHE EFIÇENCËS SË SISTEMIT TË DREJTËSISË NË SHQIPËRI
(SEJ II)**

*Raport për rolet e Kryetarëve, Kancelarëve, Këshilltarëve Ligjorë dhe
Ndhmësve Ligjorë në Shqipëri*

Tiranë (Shqipëri), 27 mars 2018

Table of Contents

1.	Hyrje	4
	Standardet ndërkombëtare për organizimin e sistemeve të drejtësisë	4
	III. Organizimi dhe administrimi i gjykatës.....	5
1.	Roli i Kryetarëve të Gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatave të apelit (këtëj e tutje ‘Kryetarët’).....	5
	a. Standardet ndërkombëtare	5
	b. <i>Mjedisi institucional në rolin e Kryetarëve në Shqipëri</i>	7
	c. <i>Detyrat e Kryetarëve</i>	7
	<i>Funksionet gjyqësore (në gjykatat e shkallës së parë/në gjykatat e apelit)</i>	8
	<i>Funksionet administrative</i>	8
	<i>Funksionet organizative</i>	9
	d. Kryetari në raport me aktorë të tjerë gjyqësorë	10
	e. Kryetari i Gjykatës së Lartë.....	10
	f. Komente përmbyllëse për rolin e Kryetarëve	10
2.	Roli i Kancelarëve (ekuivalenti evropian do të ishte menaxheri i Gjykatës).....	12
	a. Standardet ndërkombëtare	12
	b. Sfondi Institucional në lidhje me rolin e Kancelarëve në Shqipëri	12
	c. Detyrat e Kancelarëve	13
	d. Komente përmbyllëse për rolin e kancelarëve	14
3.	Roli i ndihmësve ligjorë (termi Evropian ekuivalent me Këshilltarin Ligjor/Ndihmësin Juridik)	15
	a. Standardet ndërkombëtare	15
	b. Konteksti institucional në lidhje me rolin e Ndihmësve Ligjorë në Shqipëri	16
	c. Detyrat e ndihmësve ligjorë.....	17
	<i>i. Këshilltarët Ligjorë</i>	17
	<i>ii. Ndihmësit ligjorë</i>	17
	d. Komente përmbyllëse për rolin e Ndihmësve Ligjorë.....	18
V.	Rekomandime	20
	1. Rekomandime për rolin e kryetarëve	20
	2. Rekomandimet për rolin e Kancelarëve	21
	3. Rekomandime për rolin e Ndihmësve Ligjorë.....	22
	Shtojca 1 - Kuadri ligjor për rolin e Kryetarëve të Gjykatës.....	24
	Shtojca 2 - Kuadri ligjor për statusin dhe rolin e Kancelarëve	25
	Shtojca 3 - Kuadri ligjor për statusin dhe rolin e ndihmësve ligjorë	26
	Shtojca 4 - Tabela për rolin e Kryetarëve në kuadër të CCJE-së (Opinion 19)	27

1. Hyrje

Në kuadrin e Projektit të BE/KiE për Forcimin e Efiçencës dhe Cilësisë së Drejtësisë në Shqipëri (SEJ II), më 14 nëntor 2017 u zhvillua një takim me 3 uorkshope specifike në lidhje me rolin e Kryetarëve, Kancelarëve, Këshilltarëve Ligjorë (të Gjykatës së Lartë) dhe Ndhmësve Ligjorë (të Gjykatave të Apelit) në kontekstin e reformës në drejtësi në Shqipëri. Ky aktivitet u organizua pas miratimit të ligjeve të reja në këtë fushë dhe kërkesës së shprehur për mbështetje gjatë aktiviteteve këshilluese të SEJ II nga kryetarët e gjykatave, për të kuptuar më mirë praktikën e roleve dhe përgjegjësitë të reja në kuadrin e funksioneve të ndryshme. Ekspertët e CEPEJ, z. Jon Johnsen, z. Vivien Whyte dhe z. Marco Fabri, prezantuan standardet evropiane dhe disa shembuj praktikash të mira të shteteve anëtare. Përveç kësaj, u angazhuan në diskutime të frytshme me pjesëmarrësit për të adresuar shqetësimet e tyre në lidhje me interpretimin e mundshëm dhe pyetjet mbi rolet dhe detyrat e reja. Roli i ekspertëve ishte të ofronin mbështetje në këtë aspekt, me shembuj praktikash nga vendet evropiane për t'i ndihmuar pjesëmarrësit t'i përmbushin si duhet detyrat e tyre.

Kështu, raporti synon të adresojë nevojat e përbashkëta të kryetarëve, kancelarëve, këshilltarëve ligjorë dhe ndihmësve ligjorë, për të kuptuar më mirë rolet dhe detyrat, si kusht për përdorimin me efiçencë të burimeve njerëzore, si edhe për shpërndarjen e ekuilibruar të çështjeve. Kjo është e rëndësishme, po të kemi parasysh numrin e çështjeve të akumuluar në gjykatat shqiptare. Ky shqetësim kryesor, sidomos në gjykatat e mesme dhe të mëdha dhe veçanërisht në gjykatat administrative (gjykatat e shkallës së parë dhe gjykatat administrative të apelit), bëhet vërtet akut parë nga këndvështrimi i afateve ligjore për kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore parashikuar së fundmi me ligj. Kjo nënkupton¹ se gjykatat duhet të adresojnë administrimin dhe organizimin e duhur të drejtësisë, duke marrë njëkohësisht parasysh afatet e dëshiruara të procedurave gjyqësore në përputhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

Nga sa më sipër, raporti ka për qëllim të ofrojë njohje të mirë të standardeve ndërkombëtare dhe të përshkruajë si janë pasqyruar ato në kuadrin ligjor vendas në Shqipëri në rregullimin e rolit të kryetarit, kancelarit, këshilltarit ligjor dhe ndihmësit ligjor në gjykata. Si pikënisje, ky raport shikon nëse janë marrë parasysh rekomandimet e bëra në projektin SEJ I (2014-2016), në raportin e CEPEJ “Për organizimin e gjykatave dhe kapacitetet e administratorëve të gjykatave në Shqipëri”² në reformën e gjyqësorit, për t'i mbështetur përfituesit në këtë fushë me rekomandime të mëtejshme dhe të përditësuara dhe relevante për zhvillimet e fundit të reformës.

Standardet ndërkombëtare për organizimin e sistemeve të drejtësisë

Standardet ndërkombëtare burojnë kryesisht nga Libri i Bardhë i EUR-it për *Rechtspfleger* dhe nga Rekomandimi i Këshillit të Evropës 86(12) “Për masat për parandalimin dhe reduktimin e mbingarkesës në gjykata”. Udhëzimet i nxisin autoritetet gjyqësore në shtetet anëtare të marrin masa që synojnë reduktimin gradual të detyrave jogjyqësore që u janë ngarkuar gjyqtarëve, duke ua caktuar këto detyra personave ose organe të tjera. Balancimi i ndarjes së detyrave mes gjyqtarëve dhe personelit jogjyqësor varet drejtpërdrejt nga organizimi i gjyqësorit në shtetin përkatës. Ndikimi i këtyre rekomandimeve varet edhe nga struktura e shtetit, drejtimi i gjyqësorit, shkalla e pavarësisë së gjyqtarëve, madhësia e shtetit dhe konteksti historik, shoqëror, politik dhe ekonomik. Për shembull, shtetet me gjyqësor të centralizuar (si Italia, Franca, Finlanda dhe Portugalia) ndjekin praktikë të ndryshme nga shtetet me organizim federal të gjyqësorit (si Gjermania, Austria, Spanja dhe Zvicra).

¹ Ndryshimi në Kodin e Procedurës Civile (hyrë në fuqi më 5 nëntor 2017) ka parashikuar afate ligjore për kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore në çdo shkallë juridiksioni, duke përfshirë edhe procedurat për ekzekutimin e vendimeve për çdo kategori çështjesh (administrative, civile dhe penale)

²Që trajtuan tre fusha kryesore: 1) organizimin e gjykatës, kuadrin ligjor dhe praktikën e punës në sistemin e drejtësisë në atë kohë, 2) parimet ndërkombëtare në këtë aspekt, dhe 3) shembuj sistemesh drejtësie që mund të përshtaten në Shqipëri në të ardhmen.

Parimet bazë të vlefshme për organizimin e gjyqësorit mbështeten në parimin e përgjithshëm të pavarësisë gjyqësore. Gjyqësori i pavarur dhe i paanshëm është institucioni me vlerën më të lartë në çdo shoqëri dhe shtylla themelore e lirisë dhe shtetit të së drejtës. Pavarësia gjyqësore përfshin dhe pasqyron parimin e autonomisë individuale mes gjyqtarëve (*përballë* kolegëve të tyre) dhe pavarësisë së jashtme të gjykatave. Me fjalë të tjera, si gjyqtarët ashtu edhe gjykata dhe shërbimet administrative nuk duhet të kenë ndikim të paligjshëm nga dy degët e tjera të pushtetit: legjislativi dhe ekzekutivi. Ky parim është zhvilluar më tej në disa instrumente ndërkombëtare (me efekt detyrues dhe bindës), si:

- Parimet Themelore për Pavarësinë e Gjyqësorit (të miratuara nga rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në vitin 1985) përbëjnë tekstin e parë ndërkombëtar që formulon standardet etike për gjyqtarët. Synimi i tyre është të garantojnë pavarësinë e gjyqësorit, si edhe të drejtën e çdo individi për një gjykim të drejtë dhe publik, para një gjykate të pavarur dhe të paanshme, sipas nenit 10 të DUDNj-së dhe nenit 14 të KNDCP-së.
- Karta Universale e Gjyqtarit³ thekson rregullat dhe detyrimet bazë që lidhen me etikën gjyqësore, si detyrimi për të qenë të paanshëm dhe për t'u perceptuar si të tillë (neni 5), si dhe detyra të tjera përkatëse. (neni 7).
- Parimet e Bangalorit⁴ përbëhen nga një kod vendimtar i etikës gjyqësore, vetëm për gjyqtarët dhe jo për shtetet. Ai identifikon gjashtë vlerat bazë të gjyqësorit: pavarësinë, paanshmërinë, integritetin, drejtësinë, barazinë, kompetencën dhe përkushtimin, të lidhura me përkufizimet e tyre përkatëse dhe standardet e nevojshme të etikës gjyqësore.
- Rekomandimi për pavarësinë, efikasitetin dhe rolin e gjyqtarëve (Rec (94) 12)⁵ adresuar shteteve anëtare, përsërit qëllimin e dyfishtë të standardeve etike (individuale dhe institucionale) për të siguruar detyrimin e gjyqtarëve për garantimin e mbrojtjes së të drejtave individuale dhe për mbrojtjen e pavarësisë së gjyqësorit si një pushtet i shtetit.
- Karta Evropiane për Statutin e Gjyqtarëve e Këshillit të Evropës⁶ përcakton disa kërkesa për gjykatën dhe gjyqtarët në lidhje me kompetencat, pavarësinë dhe paanshmërinë e tyre. Ajo i referohet kryesisht mbrojtjes së të drejtave individuale, por nuk është kod etike për gjyqtarët.
- *Magna Carta*⁷ e Gjyqtarëve thekson parimet e etikës gjyqësore, por edhe standardet për sistemin e drejtësisë. Ajo thekson përgjegjësinë në kontekstin ndërkombëtar dhe kombëtar për gjyqtarët dhe për shtetet, mbështetur në kriteret e shtetit të së drejtës dhe parimet etike.

III. Organizimi dhe administrimi i gjykatës

1. Roli i Kryetarëve të Gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatave të apelit (këtej e tutje 'Kryetarët')

a. Standardet ndërkombëtare

Sipas praktikave evropiane, ka disa modele që përcaktojnë rolin e Kryetarëve, por në shumë shtete, Kryetari emërohet formalisht nga një autoritet ekzekutiv. Mjedisi ligjor dhe institucional i shtetit prek gjithashtu procesin e përzgjedhjes dhe rekrutimit, si dhe afatin e tyre. Në disa shtete, Kryetarët përfshihen në përcaktimin e buxhetit gjyqësor,⁸ në rekrutimin e personelit të gjykatës,⁹ në procedurat

³ Miratuar nga Shoqata Ndërkombëtare e Gjyqtarëve më 11.17.1999

⁴ Drafti i kodit të Bangalorit i etikës gjyqësore 2001, i miratuar nga Grupi gjyqësor për fuqizimin e integritetit gjyqësor, i rishikuar në takimin e Kryetarëve të Gjykatave në tryezën e rrumbullakët të mbajtur në Pallatin e Paqes në Hagë, më 25-26 nëntor, 2002

⁵ Miratuar nga Këshilli i Evropës, Komiteti i Ministrave në 1994

⁶ Miratuar më 8-10 korrik 1998

⁷ Miratuar nga Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë në takimin e 11-të plenar (Strasbourg, 17-19 nëntor 2010)

⁸ Gjermani, Finlandë

⁹ Danimarkë

disiplinore,¹⁰në caktimin e çështjeve për gjyqtarët¹¹dhe në miratimin e rregullave të praktikës për afatet gjyqësore (në nivel vendor dhe kombëtar).¹²Për shembull, në Shqipëri, siç përmendet me poshtë, statusi dhe pushteti i Kryetarëve kanë ndryshuar si pasojë e reformës në gjyqësor, me qëllim balancimin e detyrave të tyre gjyqësore dhe drejtuese (menaxheriale).

Praktikat ndërkombëtare në nivel evropian synojnë të ndajnë rolin e Kryetarëve si *primus inter pares*, nga roli i administratorëve të gjykatave. Opinioni nr.19 i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë (CCJE) sugjeron një kombinim proporcional të funksioneve gjyqësore dhe drejtuese të Kryetarëve, duke garantuar një balancë të drejtë mes ngarkesës me çështje si gjyqtarë dhe ngarkesës së punës për organizimin dhe administrimin e gjykatës. Në disa vende, kjo nënkupton se Kryetarët kanë rol më shumë drejtues. Në thelb, ata merren drejtpërdrejt me punësimin e gjyqtarëve dhe të personelit të gjykatës, me zhvillimin e trajnimit të tyre, me krijimin e stimujve ekonomikë dhe me delegimin e kompetencave të zëdhënësit.¹³Megjithatë, opinioni nr.19 sugjeron vënien e theksit mbi funksionet gjyqësore të Kryetarëve për të mos i përjashtuar nga gjykimi i çështjeve. Prandaj, në disa shtete të tjera, Kryetarët zakonisht kanë më shumë detyra gjyqësore, duke qenë drejtpërdrejt përgjegjës për caktimin e çështjeve (caktim, ricaktim dhe priorizim i çështjeve), për monitorimin e mbledhjes së të dhënave, vlerësimin e performancës së gjykatës, për përcaktimin e afateve për kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore, për vendosjen e objektivave për gjyqtarët dhe personelin jogjyqësor¹⁴dhe për koordinimin e mbledhjeve me gjyqtarët për sinkronizimin e praktikës gjyqësore nga gjykatat më të larta.

Shembull i shteteve ku Kryetari ka rol drejtues:

Gjermani: Kryetarët kanë rolin e tyre në përgatitjen e buxhetit dhe në menaxhimin e TI-së, por nuk hartojnë rregullat e praktikës, në nivel kombëtar dhe lokal, për monitorimin e ngarkesës së çështjeve të gjyqtarëve dhe për performancën e gjykatës.

Francë: Kryetarët kanë rolin e tyre në administrimin e hapësirës së gjykatës dhe në administrimin e përfitimeve anësore për personelin e gjykatës. Megjithatë, ata nuk luajnë asnjë rol në miratimin e rregullave të praktikës as në nivel kombëtar dhe as në nivel lokal, si dhe as në garantimin e interpretimit të vazhdueshëm të ligjit brenda gjykatës.

Shembuj të shteteve ku Kryetari ka rol gjyqësor:

Itali: në Itali, Kryetari nuk ka asnjë rol në buxhetin e gjykatës, në punësimin e punonjësve të gjykatës, në ofrimin e përfitimeve anësore apo në menaxhimin e TI-së, por ata kanë kompetenca të miratojnë rregullat e praktikës, në nivel kombëtar dhe lokal, për përcaktimin e afateve kohore gjyqësore dhe për vendosjen e objektivave për miratimin e performancës së gjykatës. Përgjithësisht, ato luajnë rol në standardizimin e praktikës gjyqësore.

Shembuj të shteteve ku roli i Kryetari është kombinim i ndarë në mënyrë të barabartë me të dy detyrat:

Suedi: Kryetarët mund të rregullojnë pagat e gjyqtarëve dhe sekretarëve të gjykatave. Gjithashtu, ata kanë kompetenca të monitorojnë bazën e të dhënave, afatet kohore dhe performancën e gjyqtarëve.

Finlandë: Kryetarët përfshihen në përgatitjen dhe administrimin e buxhetit të gjykatës dhe në punësimin e punonjësve të gjykatës. Gjithashtu, ata luajnë rol në caktimin e çështjeve për gjyqtarët, si dhe në krijimin e rregullave lokale të praktikës.

Holandë: Kryetarët përfshihen në vlerësimin e buxhetit dhe në punësimin e punonjësve të gjykatës etj. Gjithashtu, ata janë të autorizuar të krijojnë rregullat e praktikës në nivel kombëtar për përcaktimin e afateve gjyqësore, si dhe për caktimin e çështjeve për gjyqtarët.

¹⁰Republika Çeke (kufizohet në Francë, Gjermani dhe Holandë)

¹¹Holandë, Poloni, Finlandë, Danimarkë

¹²Gjermani (më përgjithësisht në Itali, Holandë, Finlandë, Danimarkë, Republika Çeke

¹³P.sh. në Suedi, Kryetarët mund të vendosin pagat e gjyqtarëve dhe sekretarëve të gjykatave. Gjithashtu, ata janë përgjegjës për monitorimin e bazës së të dhënave, afatet kohore dhe për performancën e gjyqtarëve

¹⁴Republika Çeke, Finlandë dhe Suedi – teorikisht, Rumani, Sloveni, Lituani

b. Mjedisi institucional në rolin e Kryetarëve në Shqipëri

Pjesë e mangësive të rregullores së mëparshme¹⁵që prej 2013, ose më parë, është se ligji nuk u ka dhënë Kryetarëve autoritet të drejtpërdrejtë ose të qartë në çështjet organizative dhe operacionale që lidhen me administrimin gjyqësor. Për më tepër, Kryetarët nuk kishin instrumentet e duhura ligjore për drejtimin dhe kontrollin e shërbimeve ndihmëse në gjykatë, duke e transferuar këtë detyrë te Kancelarët. Prandaj, dispozitat përkatëse u kundërshtuan duke u konsideruar si jokushtetuese.¹⁶Për pasojë, u krijua një boshllëk ligjor që shkaktoi pasiguri organizative rreth mënyrës së interpretimit të kompetencave të Kryetarit, si p.sh. detyra për të punësuar dhe pushuar nga puna sekretarët gjyqësorë dhe personelin teknik administrativ. Për shkak të boshllëkut legjislativ, Kryetarët hartuan praktika të fragmentuara nga gjykata në gjykatë, në përpjekje për të kryer detyrat e tyre në lidhje me buxhetin, caktimin e çështjeve (ndarjen e çështjeve me short), shpërndarjen dhe ndarjen e gjyqtarëve në dhoma dhe seksione, si dhe caktimin e gjyqtarëve për gjyqe çdo muaj. Për më tepër, gjatë procesit të rekrutimit nuk kishte asnjë indicie që të tregonte domosdoshmërinë e këtyre aftësive. Në të vërtetë, specifikimet personale lidhen kryesisht me studimet dhe përvojën ligjore. Rekomandimet e bëra gjatë SEJ I, theksuan nevojën për mbushjen e këtij boshllëku ligjor dhe adresuan mangësitë, duke ofruar zgjidhjen e duhur për qartësimin e strukturës së qeverisjes, duke përfshirë ripërcaktimin e detyrave të Kryetarëve të gjykatave duke lidhur përgjegjësitë e tyre specifike me aftësitë, kapacitetet dhe trajnimin. Për këtë qëllim, raporti i SEJ propozoi dy modele: a) një Kryetar që ka përgjegjësi vendimtare drejtuese; b) një Kryetar që ka a vetëm përgjegjësi mbikëqyrjeje dhe orientuese për administrimin e gjykatës, i mbështetur nga Administratori i Gjykatës. Sipas raportit të SEJ, modeli i dytë (i zgjedhur nga ligjvënësit shqiptarë), sugjeron se (shihni Rec.2):

“Përgjegjësia e Kryetarit nuk kërkon domosdoshmëri të fortë drejtuese, të cilat duhet t'i ketë Administratori i Gjykatës. Sidoqoftë, është e nevojshme të ketë një lidhje të fortë mes dy pozicioneve sa i përket pavarësisë formale (hierarkike) të Administratorit të Gjykatës ndaj Kryetarit, si dhe një nivel të lartë besimi dhe konfidence. Duhet vendosur mekanizmat e duhur të llogaridhënies për rolin e mbikëqyrjes të Kryetarit.

c. Detyrat e Kryetarëve

Sipas CCJE (Opinion nr.19) dhe në dritën e praktikave evropiane, përgjegjësitë e Kryetarëve të gjykatave mund të ndahen mes tri llojeve të roleve:

- **Funksionet gjyqësore:** përfshijnë rolin ekskluziv të Kryetarit për të punuar me një volum të caktuar çështjesh gjyqësore, rolin e tyre për të garantuar interpretimin konsistent të ligjit dhe çështje të tjera të rëndësishme që dalin nga praktika gjyqësore, rolin e tyre në administrimin e drejtësisë në caktimin e çështjeve te gjyqtarët dhe ndihmësit ligjorë etj,
- **Funksionet drejtuese:** përfshijnë si rolin në administrimin e gjykatës edhe rolin në administrimin e afateve gjyqësore.
- a) Roli i Kryetarëve për administrimin operativ të gjykatës, përfshin administrimin e personelit të gjykatës (përzgjedhjen dhe punësimin, vendosjen e niveleve të shpërblyerimit, transferimin, disiplinën, vlerësimin e performancës dhe largimin), vlerësimin e performancës së gjyqtarëve individualë, administrimin e burimeve për sigurinë e infrastrukturës së gjykatës, administrimin e buxhetit të gjykatës etj.

¹⁵ Ligji nr. 9877/2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”

¹⁶Për këto arsye, Gjykata Kushtetuese¹⁶i shpalli dispozitat përkatëse si antikushtetuese¹⁶duke dalë në përfundim se:

“sa i përket pavarësisë organizative të gjykatave, si shprehje e pavarësisë gjyqësore, shmangia e detyrave gjyqësore të Kryetarit nga çështje që lidhen me organizimin, administrimin dhe kontrollin e llogaridhënies së administratës gjyqësore, si dhe emërimin dhe largimin e personelit, do të krijonte premisa për ndikim të jashtëligjshëm në funksionin ekskluziv të gjyqësorit në dhënien e drejtësisë”.

- b) Roli i Kryetarit në drejtimin gjyqësor përfshin monitorimin e kohëzgjatjeve të proceseve gjyqësore, të ngarkesës së punës së gjykatës dhe të gjyqtarëve, vendosjen e rregullave të praktikës ose e rregullave "lokale" të praktikës për afatet optimale etj.
- **Funksionet organizative:** përfshijnë rolin e Kryetarëve në planifikimin strategjik si përfaqësues të gjykatës në lidhje me palë të treta, rolin e tyre në përbërjen e trupave gjyqësore dhe përcaktimin e strukturës së gjykatës etj.

Balancimi i këtyre tre funksioneve në shtete ku Kryetari ushtron një kombinim të këtyre 3 roleve, duhet të jetë agregat i faktorëve ndikues si: organizimi i gjyqësorit, konteksti historik, socio-politik dhe ekonomik, madhësia e shtetit, niveli i pavarësisë së brendshme dhe të jashtme të gjyqtarëve dhe llogaridhënia e tyre.

Duke pasur parasysh sa më sipër, mund të thuhet se në Shqipëri, Kryetarët do t'i luajnë këtë rol të ndryshme në cilësi të ndryshme. Funksionet organizative i caktohen në cilësinë e plotë si Kryetar, funksionet drejtuese (menaxheriale) i janë caktuar në cilësinë e Kryetarit të Këshillit të Gjykatës dhe funksionet gjyqësore i janë caktuar tij si kryetar i mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve.

Funksionet gjyqësore (në gjykatat e shkallës së parë/në gjykatat e apelit)

Raporti i SEJ evidentoi se¹⁷ ngarkesa e çështjeve të Kryetarëve, përpara ndryshimeve në legjislacion, ka qenë 50% e ngarkesës së punës së një gjyqtari normal. Duke pasur parasysh funksionet e forta drejtuese dhe organizative të Kryetarëve në administrimin e gjyqësorit në atë kohë, përqindja e ulët e ngarkesës së çështjeve të tyre ishte arsyeshëm proporcionale. Aktualisht, duke qenë se detyrat në lidhje me administrimin e gjykatës u janë reduktuar, duhet rishikuar niveli i ngarkesës së çështjeve për Kryetarët.

Legjislacioni i jep Kryetarit të gjykatës, rolin e kryetarit të mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve,¹⁸ që nënkupton se ata duhet të thërrasin rregullisht, të paktën një herë në muaj, mbledhjen e gjyqtarëve dhe të diskutojnë çështje të natyrës ligjore, vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e gjykatave të tjera, vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor etj. Në këtë detyrë, Kryetarët luajnë rolin e tyre në garantimin e interpretimit konsistent të ligjit brenda gjykatës dhe në unifikimin e praktikës gjyqësore.

Gjithashtu, Kryetarët kanë të drejtë të caktojnë "çështjet më urgjente" për gjyqtarët në fillim të vitit, sipas një liste, e cila përditësohet kurdo që është e nevojshme sipas rendit alfabetik në bazë të mbiemrit. Praktika e mëparshme cilësonte si urgjente vetëm ato çështje që synonin të vlerësonin arrestin ose ndalimin rutinë, apo vendosjen e masave të sigurisë dhe çdo kërkesë tjetër gjatë fazës së investigimit. Duhet përcaktuar qartësisht se cilat janë "çështjet urgjente" me prioritet, bazuar në kriteret e GjEDNj-së dhe në udhëzimet e CEPEJ' SATURN.

Në gjykatat e apelit, Kryetari ka si detyrë vetëm të caktojë detyra për ndihmësit ligjorë bazuar në të njëjtat kriteret. Megjithatë, ata nuk kanë autoritet të mbikëqyrin njësinë e shërbimit ligjor ose të vendosin rregullat e procedurës, detyrë e cila i atribuohet vetëm KLGJ-së (Neni 42 i Ligjit për OPGJ).

Funksionet administrative

¹⁷ Shihni faqen 42, raporti i SEJ I "Shqyrtimi i kapaciteteve të organizimit të gjykatës dhe të Administratorëve të gjykatave në Shqipëri"

¹⁸ Shihni nenin 29 dhe 40 të ligjit nr. 98/2016 për organizimin e pushtetit gjyqësor

Sipas legjislacionit, Kryetari përfshihet drejtpërdrejt në administrimin e personelit të gjykatës, veçanërisht, në veprimtaritë ditore të gjyqtarëve. Kjo do të përfshinte:

- Mbikëqyrjen e disiplinës së punës së gjyqtarëve dhe kërkesën për nisje të hetimeve për sjellje të gjyqtarëve, të supozuara si jodisiplinore në gjykatat e tyre;
- Pezullimin e një magjistrati bazuar në provat që mbulohe nga nenet 151-154 të ligjit
- Mbikëqyrjen e etikës gjyqësore dhe solemnitetin e gjyqtarëve, si dhe vlerësimin e tyre për angazhim etik ndaj vlerave profesionale (Neni 75)
- Dhënien e opinionit për vlerësimin e përgjithshëm të magjistratëve (nenet 75, 77, 85, 87,88)
- Raportimin pranë KLGJ për papajtueshmërinë ose moszgjdhjen e një magjistrati në detyrën e gjyqtarit (neni 66)
- Konfirmimin e vendimit për asistentët e magjistratëve (neni 56)
- Marrjen e pretendimeve nga magjistratët në lidhje me mosshpërbllimin e veprimtarive shtesë të magjistratëve, me të drejtën e tyre për raport mjekësor ose leje vjetore, daljen e tyre në pension të parakohshëm
- Njoftimin e KLGJ-së për vendet vakante të gjyqtarëve (Neni 61)
- Kërkesën për KLGJ-në që të caktojë një magjistrat nga skema e mobilitetit (Neni 45)

Sa u përket nëpunësve civilë gjyqësorë (*Kancelarët, Këshilltarët ligjorë, ndihmësit ligjorë dhe çdo personel tjetër administrativ*), Kryetari është i autorizuar të verifikojë ankesat, të hetojë sjelljet e pahijshme profesionale dhe të propozojë nisjen e procedimeve disiplinore ndaj kancelarëve. Për më tepër, si Kryetar i Këshillit të Gjykatës, Kryetari merr vendime së bashku me¹⁹ Zëvendës Kryetarin dhe Kancelarët për sa më poshtë:

- statusin e nëpunësit civil gjyqësor dhe përkrahjet e punës të të gjitha kategorive të punonjësve të gjykatës²⁰
- numrin e këshilltarëve ligjorë
- vlerësimin e nëpunësve civilë gjyqësorë
- trajnimin fillestar dhe të vazhdueshëm të gjyqtarëve dhe nëpunësve civilë gjyqësorë;
- ankesat e lidhura me çështje rreth infrastrukturës së gjykatës dhe shërbimet ndihmëse
- draft planin për buxhetin, të shqyrtuar nga nëpunësi i financave
- Organizimin e mbledhjeve të rregullta me përdoruesit e gjykatave
- aksesin dhe përdorimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve²¹
- zbatimin e vendimet të Këshillit të Lartë Gjyqësor

Funksionet organizative

Në këtë drejtim, legjislacioni e ngarkon Kryetarin me përgjegjësi ekskluzive për përfaqësimin e gjykatës në lidhje me palë të treta. Megjithatë, në cilësinë e tij si Kryetar i Këshillit të Gjykatës, legjislacioni i cakton Kryetarit disa role organizative, si:

- Miratimi i strukturës së gjykatës dhe i organigramës së administratës së gjykatës²²
- Caktimi i gjyqtarëve në seksione dhe panele²³
- Mbajtja e kontakteve me grupet e kontrollit të institucioneve të tjera të shtetit²⁴
- Zgjedhja e një gjyqtari si Zëvendës Kryetar²⁵

¹⁹Nenet 27, 38 të ligjit për OPGJ

²⁰dhe në raste të veçanta i përshtat ato sipas nevojave të gjykatës dhe kriterëve të punës;

²¹Në përputhje me dispozitat e ligjit "Për organet e qeverisë së sistemit të drejtësisë në Republikën e Shqipërisë"

²²sipas modelit të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe në raste të veçanta, i përshtat ato sipas nevojave të gjykatës dhe aftësive të nëpunësve

²³sipas rregullave të përgjithshme të vendosura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor

²⁴bëhet i njohur me qëllimin dhe objektin e grupit të kontrollit dhe krijon mundësi për të kryerjen e detyrës

²⁵Kryetari i Gjykatës, në cilësinë e Kryetarit të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve (neni 29, 40 i ligjit për OPGJ, zgjedh Zëvendës Kryetarin me shumicë të votave nga radhët e gjyqtarëve të asaj gjykatë;

- Diskutimi i opinioneve mbi raportin vjetor të gjykatës

d. Kryetari në raport me aktorë të tjerë gjyqësorë

Kryetari i gjykatës do të jetë përfaqësuesi i gjykatës në raport me palët e treta dhe do të mbajë kontaktet me grupet e kontrollit caktuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe nga Ministria e Drejtësisë në të gjitha inspektimet gjyqësore. Në këtë aspekt, kryetari do të njihet me qëllimet dhe objektivat e grupit të kontrollit dhe do të krijojë mundësi që ai të kryejë detyrën e vet. Gjithashtu, kryetari, në përgatitjen dhe drejtimin/modelimin e mbledhjeve të përgjithshme të gjyqtarëve, mund të diskutojë me gjyqtarët aktet e kontroleve dhe inspektimeve të kryera nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, si dhe nga aktet e tjera relevante nga Ministria e Drejtësisë. Përveç kësaj, ai mund të ftojë përfaqësues nga KLGj në mbledhjet e përgjithshme të gjyqtarëve të gjykatave ku diskutohet raporti vjetor i gjykatës. Gjithashtu, si Kryetar i Këshillit të Gjykatës, Kryetari do të bashkëpunojë me KLGj-në dhe me Ministrinë për çështje të ndryshme si numri i gjyqtarëve të gjykatës, të dhënat statistikore, ngarkesa e gjyqtarëve, IT dhe teknologjia e komunikimit, etj. Kryetaret do të bashkëpunojnë edhe me institucionet të tjera shtetërore, duke u ofruar informacion, opinione.

e. Kryetari i Gjykatës së Lartë

Sipas CCJE (Opinion nr.19), Kryetarëve të Gjykatave të Larta mund t'u jepen role më prestigjioze përveç detyrave dhe parimeve të përcaktuara në mënyrë të përgjithshme për Kryetarët e të gjitha gjykatave. Para ndryshimeve, Kryetari i Këshillit të Lartë në Shqipëri ishte gjithashtu *ex officio* Kryetari i Konferencës Gjyqësore Kombëtare, anëtar i KLGJ-s, Kryetar i Bordit të Shkollës së Magjistraturës, Kryetar i Bordit të Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor dhe Kryetar i Këshillit për Emërimin e Gjykatës së Lartë që këshillon Presidentin e Republikës. Sipas legjislacionit të ri, Kryetari i Gjykatës së Lartë nuk është më anëtar i institucioneve të sipërpërmendura, përveç Bordit të Shkollës së Magjistraturës. Kryetari i Gjykatës së Lartë do të ketë gjithashtu autoritetin për të mbledhur takimin e përgjithshëm të gjyqtarëve të të gjitha gjykatave, në të gjitha nivelet e juridiksionit, për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të KLGJ-së (Neni 13). Përveç kësaj, ligji i ri ²⁶parashikon procedurë të ndryshme për zgjedhjen e Kryetarit të HC nga ajo e zgjedhjes së Kryetarëve të gjykatave të tjera. Kështu, Kryetari i Gjykatës së Lartë do të zgjidhet nga mbledhja e përgjithshme e gjykatës, për një periudhë tre-vjeçare, pa të drejtë rizgjedhjeje ²⁷me shumicën absolute të votave të të gjithë anëtarëve të mbledhjes së përgjithshme.²⁸ Përveç kësaj, në Gjykatën e Lartë, Kryetari ka autoritet mbi Njësinë e Shërbimit Ligjor, duke pasur në mandatin e tij caktimin e detyrave këshilltarëve ligjor.²⁹

f. Komente përmbyllëse për rolin e Kryetarëve

Megjithëse përgjegjësitë e Kryetarit janë reduktuar në lidhje me menaxhimin e shërbimeve gjyqësore siç shpjegohet më sipër, funksionet e tyre janë përforcuar si Kryetarë të Këshillave të Gjykatave dhe si Kryetar i takimit të përgjithshëm të gjyqtarëve. Në këtë kontekst, Kryetarët kanë ende një rol të rëndësishëm dhe ndikues në menaxhim dhe në këtë mënyrë, edhe në performancën e gjykatave, duke pasur parasysh rolin e tyre koordinues në organizimin tërësor të gjykatës.

²⁶Neni 51 i Ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve

²⁷ Që një kandidat të zgjidhet kryetar gjykate, ai duhet të ketë të paktën tre vite eksperiencë në një gjykatë relevante, nuk duhet të ketë masa disiplinore në fuqi dhe duhet të jetë vlerësuar të paktën "shumë mirë" në dy vlerësimet e mëparshme të performancës etike dhe profesionale.

²⁸ Nëse në raundin e parë të votimit, asnjë nga kandidatët nuk merr numrin e nevojshëm të votave, mbahet menjëherë një raund i dytë mes dy kandidatëve që kanë marrë numrin më të lartë të votave. Nëse edhe në raundin e dytë, asnjë kandidat nuk merr numrin e nevojshëm të votave, do të konsiderohet i zgjedhur magjistrati me numrin më të madh të votave.

²⁹ Në këtë rol, Kryetari duhet të marrë parasysh eksperiencën dhe ekspertizën profesionale dhe të ndajë në mënyrë të barabartë ngarkesën e tyre. Përveç kësaj, si Drejtues të mbledhjeve të përgjithshme, ata mund edhe të vendosin udhëzime ose orientime procedurale për funksionin e njësisë së shërbimit ligjorë dhe për numrin e këshilltarëve ligjorë që duhet t'i paraqiten KLGJ-s.

Duke qenë se Kryetarët janë të përfshirë në ndarjen e çështjeve, ata janë rrjedhimisht përgjegjës për përgatitjen e një liste gjyqtarësh për t'iu caktuar çështjet më urgjente, gjë që kërkon një përkufizim të termit "çështje urgjente ose me prioritet", bazuar edhe në kriteret e përcaktuara nga GjEDNj-ja. Sipas praktikës ekzistuese, me çështje urgjente kuptohen ato çështje si për shembull kërkesat penale gjatë hetimeve paraprake dhe kërkesave civile me natyrë urgjente. Në këto çështje, kërkesat transferoheshin nga kryetari i gjykatës tek një gjyqtar i caktuar për të qenë i disponueshëm gjatë periudhës së caktuar. ³⁰Ndërkohë që kriteret e GjEDNj-së përcaktojnë si çështje prioritare ato çështje që kanë të bëjnë me gjendjen shëndetësore/jetën e kërkuetit, ushtrimin e autoritetit prindëror, moshën e madhe të kërkuetit, mosmarrëveshjet në marrëdhëniet e punës, kohëzgjatjen e dënimit me burg kryer nga kërkueti, kapacitetin e gjendjes fizike individuale, çështjet në lidhje me dhunën e policisë, dëmshpërblimin e dëmeve të viktimave të aksidenteve, etj.³¹

Kryetarët e gjykatave të apelit dhe kryetari i Gjykatës së Lartë kanë autoritetin t'u caktojnë çështje këshilltarëve ligjorë dhe ndihmësve ligjorë. Për këtë arsye, mund të përcaktohen paraprakisht disa kriteret për caktimin e çështjeve duke shtjelluar më tej kërkesat profesionale, llojin e detyrave, llojin dhe natyrën e çështjeve dhe ekspertizën e nevojshme. Më shumë vëmendje duhet t'i kushtohet autoritetit të Kryetarëve në përcaktimin e procedurave për funksionimin e njësisë së shërbimit ligjor në Gjykatën e Lartë dhe për miratimin e numrit të këshilltarëve ligjorë. Me qëllim përcaktimit të marrëdhënies së qartë mes Këshilltarëve Ligjorë dhe Gjyqtarëve mund të përcaktohen procedurat për mënyrën e funksionimit të Njësisë së Shërbimit Ligjor (e cila përbëhet nga këshilltarë ligjorë). Kjo marrëdhënie e përcaktuar që nga momenti i caktimit të një çështjeje deri në paraqitjen e opinionit para gjyqtarit, mund të bazohet në mekanizmat e përshtatshëm të përgjegjshmërisë së Këshilltarëve Ligjorë, vizibilitetit të punës së tyre dhe monitorimit të ngarkesës së punës së tyre dhe garancive të tjera procedurale.

Përveç kësaj, Kryetarët kanë detyrimin të sigurojnë drejtësi të drejtë dhe të paanshme, gjë që kërkon në mënyrë të pashmangshme që ata të kontribuojnë në përcaktimin e qëllimeve dhe në hartimin e strategjive që adresojnë sfida të ndryshme dhe çështje që prekin gjyqësorin. Në këtë kontekst, rekomandohet që Kryetarët të mund të marrin pjesë në procesin e përcaktimit të rregullave të praktikës me qëllim përfshirjen në to të nevojave dhe kërkesave specifike të gjykatës. Duke qenë se legjislacioni/rregullorja/udhëzimet nuk nënkuptojnë asnjë lloj autoriteti të Kryetarëve në përcaktimin e afateve kohore për ritmin e procedurave gjyqësore apo për fazat specifike të procedurave gjyqësore, as edhe në përcaktimin e objektivave të nevojshme për monitorimin e kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore, ngarkesën e gjykatave apo atë të gjyqtarëve, nevojitet që ky autoritet të përcaktohet përmes interpretimit të ligjit, duke i lejuar Kryetarit që të miratojë në nivel lokal disa rregulla praktike në lidhje me eficientësinë e menaxhimit të kohës gjyqësore.

Duke pasur parasysh në mënyrë të veçantë rolin që i njihet Kryetarit të Gjykatës së Lartë, mund të sugjerohet që ata të mund të kenë edhe detyra të tjera specifike sipas pozicionit që zënë në gjyqësorin kombëtar. Këto detyra mund të përfshijnë:

- i) përfaqësimin e gjyqësorit kombëtar
- ii) ofrimin e opinionëve që pasqyrojnë pikëpamjet e gjyqësorit në lidhje me zhvillimet strategjike dhe me shtjellimin e legjislacionit që prek funksionimin e gjyqësorit,
- iii) konsultimi në procesin e përgatitjes së buxhetit të shtetit dhe në ndarjen e burimeve sa i përket buxhetit gjyqësor, iv) përgatitjen e raporteve vjetore në vëmendje të Kuvendit në lidhje me gjendjen e gjyqësorit, për të përmendur vetëm disa prej tyre.

³⁰ Shih vendimin e këshillit të lartë të Drejtësisë nr. 238/a/1, datë 24.02.2008 dhe raportin e vlerësimit të SEJ I "organizimi i Gjykatave dhe kapacitetet e administratorëve të gjykatave" 2015.

³¹ Shih raportin e CEPEJ (2006)15 "kohëzgjatja e Procedurave Gjyqësore në Evropë", takimi i 8 plenar (Strasburg, 6 - 8 dhjetor 2006)

2. Roli i Kancelarëve (ekuivalenti evropian do të ishte menaxheri i Gjykatës)

a. Standardet ndërkombëtare

Objektivat kryesore të gjyqësorit mund të jenë përcaktimi i misionit, vizionit dhe strategjisë së gjykatës për një performancë më të mirë të gjykatës në konsultim me aktorët e interesuar, gjyqtarët, prokurorët dhe personelin e gjykatës.³² Menaxherët e Gjykatës, duke iu referuar praktikës Evropiane, janë zakonisht shefi i personelit administrativ, i ngarkuar me mbikëqyrjen e gjithë punës administrative të gjykatës. Në varësi të autonomisë së qeverisjes gjyqësore, ata mund të kenë edhe detyra të tjera në lidhje me buxhetin, ambientet e gjykatës, si dhe disiplinën në lidhje me personelin administrativ. Funkcionet e "menaxherit të gjykatës" janë zgjeruar në shumë vende si Danimarka, Finlanda, Lituania dhe Polonia, ndërkohë që ndryshime të tilla duken më pak e dukshme në Republikën Çeke, Gjermani dhe Itali. Në Gjermani dhe Poloni, menaxherët e gjykatave të gjykatave më të larta kanë edhe më shumë autoritet mbi menaxherët e gjykatave të gjykatave më të ulëta (sa i përket inspektimit, mbikëqyrjes dhe disiplinës). Në disa vende, ata zgjidhen nga Kryetari i gjykatës, kurse në vende të tjera, si për shembull në Francë, Itali dhe Poloni, ata zgjidhen nga Ministria e Drejtësisë. Në parim, roli i menaxherëve të Gjykatave (**këtej e tutje Kancelarë**) është që të menaxhojë përdorimin e burimeve, në mënyrë të tillë që gjykata të përmbushë standardet e kërkuara të performancës.

b. Sfondi Institucional në lidhje me rolin e Kancelarëve në Shqipëri

Rregullimi i mëparshëm, ligji për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor nr. 9877/2008, nuk përcaktonte në mënyrë shteruese statusin, kompetencat, vlerësimin, rekrutimin, trajnimin, disiplinimin dhe heqjen e funksionimit të Kancelarëve. Kancelarët emëroheshin në bazë të një vendimi të Ministrisë së Drejtësisë dhe përfaqësonin personelin më të lartë administrativ të gjykatës.³³ Sipas këtij rregullimi, ata kishin autoritetin të vendosnin për emërimin dhe heqjen e punonjësve të gjykatës, si dhe për masa disiplinore. Megjithatë, ky autoritet pushoi së qeni në fuqi pas anulimit të dispozitave përkatëse nga Gjykata Kushtetuese. Besohej se, duke u dhënë kompetenca të tilla³⁴ Kancelarëve dhe jo Kryetarëve të gjykatave, mund të komprometohej pavarësia e gjykatave.³⁵ Ky shfuqizim krijoi një boshllëk në rregulloret e administrimit të gjykatave, gjë që e la strukturën e kompetencave mes Kancelarëve dhe Kryetarëve të gjykatave të paqartë dhe të hapur ndaj interpretimeve. Në raportin e sipërpërmendur të SEJ I, theksohej se Kancelarët në gjykatat shqiptare kishin status dhe kapacitet të dobët për të mbështetur sa duhet Kryetarët e gjykatave në ekzekutimin e detyrave të tyre në menaxhimin e gjykatës. Përveç kësaj, Kryetarët nuk kishin aftësi organizative dhe drejtuese për të kryer plotësisht detyrat e tyre në këtë aspekt. Për më tepër, Kryetarët kishin një volum më të lartë në mënyrë disproporcionale të gjykimit të çështjeve, gjë që mund të ndikonte në përmbushjen e rolit të tyre në lidhje me drejtimin dhe administrimin e gjykatës. Për këtë arsye, raporti i SEJ I rekomandoi si modelin më të mirë për strukturën e qeverisjes së gjykatave atë model ku Kryetarët³⁶ kanë për detyrë vetëm përmbushjen e përgjegjësive mbikëqyrëse, ndërkohë që forcohet aspekti i menaxhimit të gjykatës nga kancelarëve. Legjislacioni i ri adreson rekomandimet e SEJ për miratimin e këtij modeli, duke forcuar mandatin e menaxhimit të gjykatës nga kancelarët, duke përmirësuar statusin e tyre, përzgjedhjen, shkathtësitë dhe aftësitë. Në këtë kuadër, kancelarët do të kenë një rol më aktiv në sigurimin e efikasitetit të administrimit gjyqësor në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe me Kryetarët.

³²Shih paragrafët 6-9 dhe 10-18 në Shtojcën 2

³³ Sipas Ligjit Nr. 9877/2008 "Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë"

³⁴ me vendim nr. 20, datë 9.7.2009

³⁵Neni 38/a i Ligjit për pushtetin gjyqësor, nr. 9877, datë 18 shkurt 2008, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në republikën e Shqipërisë", ndryshuar, u shpall anti-kushtetues. Ligji është botuar në Gazetën Zyrtare nr. 27 Vendimi datë 29.2.2008.

³⁶ Pavarësisht kësaj, ligji i ka përfunduar kriteret përzgjedhëse për Kryetarët, duke përfshirë edhe aftësitë e tyre organizative dhe drejtuese

c. Detyrat e Kancelarëve

Ligji e përcakton vendin e kancelarëve në gradën më të lartë të nëpunësve gjyqësorë civilë.³⁷ Gjithashtu, kancelarët do të jenë një nga tre anëtarët e Këshillit të Gjykatës³⁸ dhe anëtarë të Komisionit Ristrukturimit.³⁹ Në lidhje me këtë, kancelarët do të marrin kompetenca menaxheriale në lidhje me administrimin e gjykatave, që lidhen kryesisht me nëpunësit e gjykatës (*administrative dhe mbështetës*), sistemin e menaxhimit të çështjeve, organizimin e gjykatës dhe mirëmbajtjen dhe sigurinë e ambienteve të gjykatës.

Nëpunësit e gjykatës: në lidhje me punonjësit e gjykatës, kancelarët do të vendosin për sa më poshtë:

- statusin e nëpunësve gjyqësorë civilë
- emërimin, ngritjen në detyrë, transferimin dhe shkarkimin
- vlerësimi i kualifikimeve të kandidatëve për nëpunës gjyqësor civil (neni 54)
- krijon dhe administron doje individuale për çdo nëpunës gjyqësor civil dhe për nëpunësit administrativ të gjykatës⁴⁰
- informon Këshillin e Lartë Gjyqësor për vendet vakante ose për vendet e pritshme vakante për nëpunës gjyqësor civil
- Orienton krye sekretaren për koordinimin, organizimin dhe shpërndarjen e punës në sekretari (neni. 43).

Sistemi i menaxhimit të çështjeve: Kancelarët mbajnë përgjegjësi nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Gjykatës për funksionimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve duke garantuar saktësi në mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore dhe i ofrojnë akses Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Ministrisë së Drejtësisë në këto të dhëna. Në lidhje me këtë, Kancelarët bashkëpunojnë ngushtë me KLGJ për përditësimin dhe paraqitjen e raporteve të tyre vjetore mbi përdorimin dhe funksionimin e tij.

Organizimi i gjykatës: Kancelarët do të marrin pjesë si anëtarë të Këshillit në përgatitjen e strukturës së gjykatës/organigramës së administratës së gjykatës dhe në caktimin e gjyqtarëve në seksione dhe trupa gjykimi. Ata bashkëpunojnë gjithashtu me Shkollën e Magjistraturës dhe me Këshillin e Lartë Gjyqësor për çështjet që kanë të bëjnë me trajnimin fillestar dhe trajnimin e vazhduar të nëpunësve gjyqësor civil.

Buxhetimi/siguria dhe çështjet e sigurisë: Kancelarët, si anëtar të Këshillit të Gjykatës, marrin pjesë në detyra të ndryshme dhe kanë kompetenca si:

- mbikëqyrjen e projekt buxhetit të hartuar nga nëpunësi i financës
- miratimin e rregullave specifike për çështje të menaxhimit dhe sigurisë në gjykatë
- ofrimin e informacioneve, opinioneve ose raporteve me kërkesë të institucioneve të tjera shtetërore
- organizimin e takimeve sistematike me përdoruesit e gjykatës lidhur me shërbimet e gjykatës
- shqyrtojnë ankesat në lidhje me çështje të infrastrukturës së gjykatës dhe me shërbime ndihmëse në gjykatë (dhe ia raportojnë ato KLGJ-s)⁴¹

³⁷ Neni 50 i ligjit për OPGJ-në, Nr.98/2016

³⁸ Neni 27 i ligjit për OPGJ-në Nr.98/2016 parashikon që Këshilli i Gjykatës të përbëhet prej tre anëtarëve: Kryetari, zëvendëskryetari, kancelarët,

³⁹ Sipas Neni 66, paragrafi 6 i ligjit për OPGJ-në Nr.98/2016: "Në rast të mbylljes ose riorganizimit të strukturës së një gjykate, Këshilli i Lartë Gjyqësor ngrë një Komision Ristrukturimi në kuptim të ligjit "Për Shërbimin Civil". Komisioni i Ristrukturimit kryesohet nga një perfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe përfshin kryetarë dhe kancelarë gjykatash që preken nga masat rishturuese."

⁴⁰ Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton, me vendim, rregullat e hollësishme për përmbytjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të stafit, sipas paragrafit 1 të këtij Neni, të dhënat që mbahen në to, si dhe mënyrën e ruajtjes, shtimit, përditësimit dhe përdorimit të të dhënave (neni.63)

⁴¹ Të gjitha këto detyra kryhen në bazë të rregullave të përgjithshme dhe modeleve të miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Funksionet gjyqësore: Kancelarët nuk kryejnë asnjë funksion gjyqësor. Roli i tyre për procesin e ndarjes së çështjeve gjyqësore me short, kufizohet vetëm në administrimin e dokumentacionit dhe në nënshkrimin e dorëzimit të çështjeve gjyqësorë përkatës.

d. Komente përmbyllëse për rolin e kancelarëve

Standardet më të mira Evropiane tregojnë që roli i Kancelarëve duhet të fokusohet kryesisht në menaxhimin e burimeve njerëzore dhe financiare me qëllim përmirësimin e performancës së shërbimeve të gjykatës. Duke pasur parasysh rregullimin e funksioneve dhe kompetencave të Kancelarëve, mund të dilet në këto përfundime:

- Sipas ligjit nr.98/2016, Kancelarët kanë kryesisht funksione menaxheriale/organizative dhe administrative. Duke iu referuar parimit të përqendrimit të pushtetit gjyqësor vetëm tek gjyqtarët, do të ishte me vend të hartoheshin disa udhëzime në lidhje me marrëdhëniet mes Kancelarëve dhe Kryetarëve të gjykatave/gjyqtarëve për të theksuar natyrën e funksioneve të gjyqtarëve dhe funksioneve që nuk u përkasin gjyqtarëve. Përveç kësaj, do të ishte gjithashtu e dobishme të qartësohej marrëdhënia e Kancelarëve me anëtarët e personelit që nuk janë gjyqtar, si për shembull këshilltar ligjor/ ndihmës ligjor si dhe me nëpunës të gjykatës. Për këtë qëllim, mund të hartohet një politikë komunikimi për orientimin e këtyre marrëdhënieve.
- Duke qenë se Kancelarët do të kenë kompetenca ekskluzive për emërimin, drejtimin, mbikëqyrjen dhe shkarkimin e nëpunësve të gjykatës, por do të luajnë gjithashtu edhe një rol në emërimin, transferimin, ngritjen në detyrë, trajnimin dhe shkarkimin e nëpunësve gjyqësor civil (krye sekretare, sekretare gjyqësore, financierë, specialit IT, etj.) mund të sugjerohet që Kancelarët të organizojnë edhe takime të përgjithshme me nëpunës gjyqësor civil dhe me nëpunës të gjykatës si një mënyrë për të kanalizuar komunikimin mes departamenteve të ndryshëm të gjykatës dhe për të shkëmbyer vlerësime në lidhje me çështje që kërkojnë koordinim të brendshëm (për shembull, bashkëpunimi mes strukturave të ndryshme brenda gjykatës, të cilat janë drejtpërdrejt përgjegjëse për funksionimin e sistemit elektronik të çështjeve, për menaxhimin e mbledhjes, vlerësimit, regjistrimit, monitorimit dhe shpërndarjes së të dhënave).⁴²
- Udhëzimet e CEPEJ⁴³ tregojnë se Kancelarët mund të kenë rol aktiv në menaxhimin e krizave që lidhen me performancën e gjykatës.⁴⁴ Për përmbylljen e këtyre qëllimeve, përmes përcaktimit të objektivave dhe prioriteteve, Kancelarët mund të kenë nevojë për të bashkëpunuar me aktorë të brendshëm dhe të jashtëm. Duke qenë se ligji nr.98/2016 u ka caktuar Këshillave të Gjykatave kompetencën e mbajtjes së takimeve sistematike me përdoruesit e gjykatës, bazuar në parimin e delegimit të pushtetit, Kancelarët mund të organizojnë vetëm takime me përdoruesit e gjykatës, në varësi të urgjencës së situatave eventuale.
- Udhëzimet e CEPEJ⁴⁵ kanë theksuar se eficientia e menaxhimit të kohës gjyqësore kërkon një rol më aktiv nga ana e Kryetarëve të gjykatave dhe Kancelarëve në menaxhimin e çështjeve gjyqësore me qëllim përcaktimin e objektivave për mbikëqyrjen e menaxhimit të kohës së seancave gjyqësore dhe për monitorimin e ngarkesës së punës së gjykatës dhe ngarkesën e gjyqtarëve. Duke qenë se ligji nuk nënkupton asnjë kompetencë të Kancelarëve në këtë aspekt⁴⁶ ky autorizim mund tu delegohet Kancelarëve përmes interpretimit të ligjit.

⁴² Raporti i CEPEJ (2016)12 "për matjen e cilësisë së drejtësisë", 7 dhjetor 2016

⁴³ Raporti i CEPEJ (2015)18 për zbatimin e udhëzimeve SATURN nr. 9,10,11,12,13.

⁴⁴ Raporti i CEPEJ (2014)161 për udhëzimet SATURN për aktorët e përfshirë në menaxhimin e kohës.

⁴⁵ Raporti i CEPEJ (2014)161 për udhëzimet e SATURN-it për aktorët e përfshirë në menaxhimin e kohës

⁴⁶ KL.Gj në kompetencën e saj për të miratuar rregulla për praktikën e gjykatave bazuar në nenin 94 të Ligjit për qeverisjen e institucioneve gjyqësore.

- Udhëzimet e CEPEJ kanë theksuar gjithashtu rolin që Kancelarët mund të kenë në mbledhjen dhe regjistrimin e informacioneve mbi hapat më të rëndësishëm në procesin gjyqësor ⁴⁷ dhe analizimin e vazhdueshëm të tij me qëllim ofrimin e zgjidhjeve për menaxhimin e krizave. Duke qenë se ligji nr. 98/2016 i ka dhënë një rol të rëndësishëm Kancelarëve në menaxhimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve dhe në statistikat gjyqësore të gjykatave, do të preferohej që këto detyra të shtjelloheshin më tej në kuadër të udhëzimeve të CEPEJ.⁴⁸

3. Roli i ndihmësve ligjorë (termi evropian ekuivalent me Këshilltarin Ligjor/Ndihmësin ligjor)

a. Standardet ndërkombëtare

Praktikat evropiane e kanë përmirësuar rolin e ndihmësve ligjorë bazuar në parimin e ndarjes së punës, gjë që nënkupton se ndarja e detyrave të caktuara për autoritetet gjyqësore duhet të jetë e balancuar dhe të ofrojë trajnimin dhe specializimin e duhur. Sipas këtij parimi, është e rëndësishme që i gjithë pushteti në gjykata të mos përqendrohet në një person, tek gjyqtari. Për këtë arsye, detyrat e tyre mund t'i delegohen punonjësve jo-gjyqtarë, veçanërisht ndihmësve të trajnuar për aspektin juridik ose sekretareve gjyqësore. Kështu, përmirësimi i rolit të ndihmësve ligjorë është konsideruar si pjesë e përpjekjeve për rritjen e cilësisë dhe efikasitetit të performancës së gjykatës, por edhe për të siguruar garancitë e nevojshme për të drejtën e një gjykimi të drejtë brenda një afati të arsyeshëm, sipas nenit 6 të KEDNJ-së. Në dritën e këtyre përpjekjeve, disa vende Evropiane kanë modifikuar me sukses rolin e Ndihmësve Ligjorë si një mënyrë për të balancuar ngarkesën e personelit të gjykatës, gjë që ka rezultuar në kalimin e detyrave nga gjyqtarët tek punonjësit jo-gjyqtarë. Bazuar në këto praktika, disa shembuj të nëpunësve jo-gjyqtarë të gjykatës janë si më poshtë:

- Në *Rechtspfleger* është deri diku një kategori që bie midis gjyqtarëve dhe punonjësve jo-gjyqtarë, si regjistruesi. Funkzioni i "*Rechtspfleger*" funksion është frymëzuar nga sistemet austriake dhe gjermane, ⁴⁹si një organ i pavarur gjyqësor, i parashikuar me kushtetutë dhe që kryen detyrat që i ngarkon ligji. *Rechtspfleger* nuk ndihmon, por punon së bashku me gjyqtarin dhe mund të kryejë detyra të ndryshme ligjore. Për shembull, në fushën e të drejtës familjare ose trashëgimisë, ai/ajo është gjithashtu e autorizuar për të marrë vendime të pavarura gjyqësore për dhënien e shtetësisë, lëshimin e urdhërpagesave, ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, ankandet e pronave të paluajtshme, çështjeve penale, dhe për zbatimin e vendimeve në çështjet penale. Ai/ajo është gjithashtu i kualifikuar për të kryer detyra gjyqësore administrative.
- Punonjësit jo-gjyqtarë, roli i të cilëve është të ndihmojnë drejtpërdrejtë gjyqtarët. Si këshilltarët gjyqësor, ashtu edhe regjistruesit i ndihmojnë gjyqtarët në aktivitetet e tyre gjyqësore (veçanërisht në seanca gjyqësore) dhe mund tu duhet të vërtetojnë vlefshmërinë e akteve të paraqitura para gjykatës
- punonjësit përgjegjës për çështje të ndryshme administrative dhe për menaxhimin e gjykatës
- punonjës teknik përgjegjës për pajisjet IT, siguri dhe pastrim
- Punonjës të tjerë jo-gjyqtarë.

⁴⁷Ata duhet të mbajnë të dhëna në lidhje me kohëzgjatjen midis hapave të ndryshëm, duke përfshirë veçanërisht: (1) fillimin e procedimit (2) shërbimin e procesit për palën tjetër (3) marrjen e përgjigjes nga pala tjetër (4) nxjerrjen e urdhrave proceduralë nga gjykata (4) përdorimi dhe matja e kohës së konferencave përgatitore për seancat paraprake (5) fillimin e gjykimit (6) ekzistencën dhe kohëzgjatjen e ekspertizës teknike (7) kohëzgjatjen dhe numrin e seancave dëgjimore në themel për çdo çështje (8) përfundimin e gjykimit (9) vendimmarrjen në shkallë të parë⁴⁷ (10) shpalljen dhe zbardhjen e vendimeve për palët në shkallë të parë (11) nisjen e ankimit (apeli, etj.) dhe ndikimi i tyre në kohëzgjatjen e procedurave (12) seancat në apel dhe vendimet (13) vendimet paraprake dhe urdhrat në gjykata më të larta⁴⁷ (14) rruga dhe rezultatet e apelit dhe procedurave të tjera⁴⁷ (15) faza të tjera të jashtëzakonshme⁴⁷ (16) efikasitetin e zbatimit të vendimeve të gjykatës.

⁴⁸Lista e kontrollit për menaxhimin e kohës në raportin e rishikuar të CEPEJ (2005)12, 7-9 dhjetor 2005.

⁴⁹Sipas Bashkimit Evropian të *Rechtspfleger*EUR

Shkurtimisht, janë dy forma kryesore të Ndhmësve Ligjorë: (1) ata, mandati i të cilëve mbulon drejtpërdrejt ndihmën për gjyqtarët, por pa përfshirë vendimmarrjen⁵⁰ ('*Greffier*'-i francez është shembull i mirë i këtij modeli) (2) ata që marrin pjesë në vendimmarrje pavarësisht nga çështjet e caktuara rutinë⁵¹ (si për shembull *Rechtspfleger*-i).

Siç do të shihet më poshtë, ekuivalenti i formës së parë të ndihmësve ligjorë në sistemin gjyqësor shqiptar është ai i këshilltarëve ligjorë në Gjykatën e Lartë dhe i ndihmësve ligjorë në Gjykatën e Apelit. Ata u ofrojnë gjyqtarëve asistencë të lartë juridike, kufizuar në përgatitjen e kërtimeve ligjore dhe hartimin e vendimeve. Megjithatë, ata nuk janë të autorizuar të gjykojnë as rezultatin e çështjeve të drejtpërdrejta.

b. Konteksti institucional në lidhje me rolin e Ndhmësve Ligjorë⁵² në Shqipëri

Raporti i sipërpërmendur i SEJ theksonte se legjislacioni shqiptar në fuqi në atë kohë kishte një boshllëk në lidhje me rolin dhe përgjegjësitë e Këshilltarëve Ligjorë dhe Ndhmësve Ligjorë. Mangësitë konsistonin kryesisht në faktin që Shkalla e Parë dhe Gjykatat e Apelit të juridiksionit të përgjithshëm nuk dukej se kishin ndonjë ndihmës ligjor.⁵³ Ndërsa, Këshilltarët Ligjorë në Gjykatën e Lartë të Shqipërisë nuk ishin të diplomuar për juridik, të punësuar dhe të trajnuar specifikisht për këtë detyrë, por prireshin të ishin gjyqtarë të gjykatave të shkallëve më të ulëta. Përveç kësaj, ligji nuk parashikonte asnjë kriter të qartë për detyrat që do tu caktoheshin atyre. Për të adresuar këtë mangësi, Rekomandimi 8 i SEJ sugjeronte rekrutimin më shumë të 'ndihmësve ligjorë të diplomuar në juridik, duke shfrytëzuar rolet e ngjashme në juridiksione të tjera Evropiane, që mund të përbënin një pikë të mirë referimi për përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësisve të ndihmësve'.

Sipas rekomandimeve të SEJ, legjislacioni i ri adreson mangësitë e vërejtura duke ofruar rregullim të përshtatshëm të statusit të Këshilltarëve Ligjorë/Ndhmësve Ligjorë, si dhe të procedurave për përzgjedhjen, trajnimin dhe promovimin e tyre. Ai gjithashtu tregon qartë se Këshilltarët Ligjorë/Ndhmësit Ligjorë, Krye Sekretarët dhe Sekretarët gjyqësor janë nëpunës gjyqësor civil⁵⁴ (me përkatësisht role gjyqësore, administrative⁵⁵ dhe mbështetëse)⁵⁶ të cilët ofrojnë shërbime që mbështesin në mënyrë të drejtpërdrejtë aktivitete gjyqësore. Më konkretisht, Këshilli i Lartë gjyqësor do të hartojë një listë të detyrave të tyre në përshkrimet standarde të punës dhe Këshilli i Gjykatës do të miratojë përshkrimet e tyre të punës në përputhje me nevojat e gjykatës dhe me kriteret e punës. Kryetari i gjykatës vendos për marrjen e tyre në punë (Neni 37) dhe bashkëpunon me Shkollën e Magjistraturës dhe me Këshillin e Lartë gjyqësor për çështje që lidhen me zhvillimin dhe trajnimin e tyre të vazhdueshëm profesional.

Legjislacioni shqiptar u cakton Këshilltarëve Ligjorë detyra të një niveli më të lartë krahasuar me Ndhmësit Ligjorë, si për shembull analizimin e çështjeve dhe të jurisprudencës përkatëse, si dhe

⁵⁰Sa më poshtë janë detyra të përgjithshme ligjore pa autoritet vendimmarrës; njoftim dhe ofrim informacioni për palët në lidhje me fazat e procesit gjyqësor; përgatitja e dosjeve të çështjeve; përgatitja e kopjeve; kryerja e kërtimeve ligjore; ofrimi i analizave ligjore; mbajtja e procesverbalit në seancat gjyqësore; përgatitja e vendimeve; vërtetimi i dokumenteve; njoftimi i dokumenteve.

⁵¹Relatorët jogjyqtarë të GjEDNJ-së, ndonëse nuk kanë kompetenca vendimmarrëse, janë përgjegjës për analizimin e çështjeve që duken të papranueshme ose që mund të jenë të pazakonta. Ata bëjnë një listë rekomandimesh për gjyqtarin e vetëm të Gjykatës disa herë në muaj. Kjo përbën një formë shumë të avancuar të mbështetjes ligjore që tregon se si mund të optimizohen burimet e brendshme në procesin e vendimmarrjes.

⁵²Termi evropian për ekuivalentin shqiptar sipas nivelit të juridiksionit që janë këshilltarët ligjorë dhe ndihmësit ligjorë.

⁵³Për 2014 planifikohej që të kishte 22 ndihmës ligjorë për 43 gjyqtar administrativ; 1 ndihmës për 2 gjyqtarë, 38 këshilltarët ligjorë (reduktuar aktualisht në 15) për Gjykatën e Lartë dhe dy ndihmës ligjorë për Gjykatën e Apelit të Tiranës. Gjykatat e tjera nuk kanë ndihmës ligjorë, pasi rregulloret "Për Organizimin e Gjyqësorit" dhe "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave të Krimeve të Rënda" nuk parashikonin nevojën për këtë pozicion.

⁵⁴a) Kancelar; b) Këshilltar Ligjor në Gjykatën e Lartë; c) Ndhmës Ligjorë në Gjykatën e Apelit; ç) Krye Sekretar; d) Sekretar Gjyqësor; dh) Nëpunës për Financën dhe Buxhetin; d) Nëpunës të tjerë gjyqësorë civil që punojnë në fushën e kërtimeve ligjore dhe dokumentacionit, burimeve njerëzore, teknologjisë së informacionit, arkivave, marrëdhënieve me publikun dhe marrëdhënieve me aktorët e jashtëm dhe/ose me median (neni 50)

⁵⁵ Shërbimet administrative që përfshijnë financën dhe buxhetimin, marrëdhëniet me të tretët dhe marrëdhënien me publikun, teknologjia e informacionit, arkiva gjyqësore, siguria dhe burimet njerëzore

⁵⁶ Shërbime mbështetëse që garantojnë veçanërisht performancën e shërbimit të njoftimit të akteve gjyqësore, ndihmën për trupën e gjyqësorit ose për kryesuesin e seancave gjyqësore si dhe çdo aktivitet tjetër në lidhje me zhvillimin e duhur të seancave gjyqësore, shërbimin e transportit dhe mirëmbajtjen e ambienteve të gjykatave

hartimin e përmbledhjeve të procedurave. Ndhmësit Ligjorë nga ana tjetër, analizojnë jurisprudencën dhe përpunojnë çështje me nivel të ulët kompleksiteti. Kriteri për caktimin e çështjeve të dyja kategorive bazohet në eksperiencën dhe ekspertizën e tyre profesionale, duke garantuar ndarje të barabartë të punës mes tyre. Sfida që mbetet është se si të modifikohet dinamika që duhet të ekzistojë midis Gjyqtarëve/Këshilltarëve Ligjorë dhe midis Gjyqtarëve/Ndhmësve Ligjorë me qëllim garantimin e një shpërndarjeje të drejtë dhe të ekuilibruar të detyrave për përmirësimin e detyrave për përmirësimin e efikasitetit dhe cilësisë së performancës së gjykatës.

Kjo temë ishte pjesë e agjendës së takimit të organizuar në 14 nëntor 2017 me drejtues, kancelarë dhe personel gjyqësor të gjykatave shqiptare. Në përgjithësi, personat e pranishëm në takim ranë dakord për t'i caktuar më shumë detyra ligjore punonjësve jo-gjyqtarë. Gjithashtu, gjatë diskutimeve me personelin juridik në gjykatat administrative, u ngritën shqetësime në lidhje me metodat ekzistues të punës, si për shembull:

- Duke iu referuar praktikës ekzistuese, ndihmësit ligjorë shpjeguan se duhet të përballeshin me metoda të ndryshme pune për 13-30 gjyqtarëve.
- Procedura aktuale, duke filluar nga caktimi i çështjeve ndihmësve ligjorë deri në prezantimin e opinionit të tyre para gjyqtarit nuk mund të ndiqet/gjurmohet, nuk është e dukshme dhe e bën kështu punën e tyre një punë për të cilët nuk mund të kërkohej llogari.⁵⁷
- Rregullimet ekzistuese nuk përcaktojnë organin që do të ishte përgjegjës për mbikëqyrjen e punës së ndihmësve ligjorë, kështu që ndihmësit ligjorë e gjejnë veten në pozitë të mospasjes së një eprori të caktuar, qoftë ky kryetari, kancelari apo gjyqtari.

c. Detyrat e ndihmësve ligjorë

Këshilltarët Ligjorë

Këshilltarët ligjorë në Gjykatën e Lartë⁵⁸ do të shqyrtojnë apelin, do të ndjekin dosjet e çështjeve, do të përgatisin raporte në të cilat japin mendime për çështje që lidhen me gjykimin, do t'u përgjigjen ankesave, do të përgatisin materialet përkatëse dhe do të kryejnë çfarëdolloj detyra tjetër që mund të kërkojë gjyqtari i Gjykatës së Lartë. Ligji i ri parashikon krijimin e një Njësie të Shërbimit Ligjor (NjShL) brenda Gjykatës së Lartë, i cili do të kryejë punë këshilluese dhe funksione ndihmëse gjatë procesit vendimmarrës të Gjykatës së Lartë. Kryetari do ta mbikëqyrë NjShL-në me mandatin e caktimit të detyrave këshilltarëve ligjorë. Për më tepër, si kryesues i mbledhjeve të përgjithshme të gjyqtarëve, Kryetari do të përcaktojë procedurat e funksionimit të NjShL-së dhe numrin e këshilltarëve ligjorë. Më pas, Këshilli i Gjykatës do të përfshijë rekomandimet e Kryetarit në projektbuxhet, i cili më pas i paraqitet Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ndhmësit ligjorë

Ndhmësit ligjorë në gjykatat administrative⁵⁹ do të asistojnë dhe do të këshillojnë në procesin e shqyrtimit gjyqësor dhe në shqyrtimin e çështjeve. Ata do të përgatisin dokumentet e nevojshme procedurale për gjykimin/që kërkohej për gjykimin me kërkesë të gjyqtarit. Përveç kësaj, ata do të bëjnë kërkime ligjore dhe do të përgatisin opinione me shkrim për probleme ligjore dhe procedurale që lidhen me procesin gjyqësor. Ligji i ri "Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor" (neni 42) parashikon që

⁵⁷Sipas praktikës aktuale, kryetarët dhe kancelarët ua caktojnë çështjet ndihmësve ligjorë dhe më pas u raportojnë gjyqtarëve. Sipas praktikës së zakonshme, ndihmësit ligjorë nuk marrin asnjë lloj vlerësimi për punën e tyre nga gjyqtarët, kryetarët apo kancelarët. Kjo e bën punën e ndihmësve ligjorë të vështirë për t'u ndjekur apo për t'u matur. Pati një konsensus të përgjithshëm për caktimin e kësaj përgjegjësie Këshillit të Gjykatës, që u konsiderua struktura më e mirë për mbikëqyrjen e Gjyqtarëve/njësive të ndihmësve ligjorë.

⁵⁸ Sipas rregullores "Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës së Lartë",

⁵⁹ Sipas rregullores "Për Gjykatën Administrative"

Njësia e Shërbimit Ligjor (NjShL) të jetë funksionale brenda Gjykatave të Apelit, e përbërë nga ndihmës ligjorë, ngritur me vendim ekzekutiv të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në kontrast të fortë me këtë, numri i ndihmësve ligjorë do të përgjysmohet (numri i tyre nuk do të jetë më i lartë se gjysma e numrit të gjyqtarëve për gjykatë). Edhe në gjykata e apelit, Kryetari nuk do të mbikëqyrë NjShL-në dhe as do të përcaktojë rregullat e procedurës, por vetëm do t'i caktojë detyrat ndihmësve ligjorë bazuar në të njëjtat kritere si ato të zbatuara për këshilltarë ligjorë. Këshilli i Lartë Gjyqësor do të vendosë rregulla të detajuara mbi kërkesat profesionale, natyrën e detyrave të tyre dhe llojin e çështjeve që ata pritet të përpunojnë dhe të përgatisin.⁶⁰

d. Komente përmblylëse për rolin e Ndhmësve Ligjorë⁶¹

Ligji shqiptar ka kategori të ndryshme personeli për qëllime të ndryshme: personel ligjor për mbështetje juridike për gjyqtarët, sekretarë gjyqësorë dhe kryesekretarë për punë procedurale dhe mbikëqyrëse dhe kancelarë dedikuar menaxhimit të gjykatave. Një përvijim i tillë i aftësive përcakton terrenin për një sistem të mirë-ekuilibruar dhe eficient. Megjithatë, kjo mund të arrihet vetëm përmes rekrutimeve të mjaftueshme në çdo kategori. Në fakt, ulja e raportit gjyqtar/ndihmës mund të çojë në konfuzim të roleve dhe detyrave në çdo kategori, pasi gjykatat do të kërkonin mënyra për të përballuar ngarkesën e punës duke përdorur të gjitha burimet në dispozicion.

Duket se vendet evropiane që kanë zgjedhur t'ua lehtësojnë ngarkesën gjyqtarëve duke ia transferuar një pjesë të saj punonjësve jo-gjyqtarë e kanë bërë këtë vetëm në shkallë të parë. Në të vërtetë, si rregull, çështjet që vijnë në gjykatat e larta janë komplekse dhe të diskutueshme nga natyre, gjë që justifikon gjykimin e tyre vetëm nga gjyqtarët. Rrjedhimisht, personeli ligjor në këto gjykata do të shohë kufizimin e detyrave të tyre në ofrimin e ndihmës ligjore dhe/ose këshillimeve ligjore gjyqtarëve përkatës, sidomos nëse raporti gjyqtar/ndihmës është i ulët. Dhënia e më shumë detyrave këtyre kategorive personeli nënkupton rifutjen e tyre në gjykatat e shkallës së parë.

Diskutimet aktuale për hartën gjyqësore⁶² mund të përfshijnë këto konsiderata në procesin e shqyrtimit, me qëllimin që të krijohet ekuivalenti i ndihmësve gjyqësorë në gjykatat e shkallës së parë, duke ngritur pozicionin e ndihmësve ligjorë. Kjo mund të kërkojë rekrutimin e personelit shtesë. Roli i ndihmësve ligjorë në gjykatat e shkallës së parë mund të përforcohet me kompetenca vendimmarrëse në çështje specifike pa palë kundërshtare ose ato rutinë, në mënyrë që t'ua lehtësohet gjyqtarëve një pjesë e ngarkesës. Ata mund t'i kryejnë këto detyra në mënyrë krejtësisht të pavarur, në përputhje me parimet e renditura në *Kartën e Bardhë të EUR-it për një Rechtspfleger/Greffier për Evropën*, duke miratuar sipas rastit metoda të reja për trajnimin e tyre dhe dhënien e pagave të reja. Teknologjia e informacionit dhe kompjuterike ka zhvilluar sisteme shumë të avancuara që mund të mbështesin këtë delegim të detyrave të personeli ligjore, gjë që sjell përfitime të mëdha në menaxhimin e kohës.

Nisur nga këta elementë dhe kuadrin ligjor aktual në Shqipëri, është e mundur që në gjykatat e shkallës së parë të emërohen ndihmës ligjorë me role dhe detyra të përforcuara, të cilëve u delegohen kompetenca vendimmarrëse, veçanërisht në lidhje me:

- a) Çështjet jokontradiktore (*e drejta familjare dhe kujdestaria, trashëgimia, regjistrat e tokës dhe tregtisë, vulosja e provave, prokurat zgjedhore*)

⁶⁰KL Gj-ja do të hartojë edhe rregulloret për procedurën dhe kriteret për mënyrën e ndarjes së çështjeve me short, do të vlerësojë rregullisht ngarkesën e ndihmësve ligjorë dhe do të garantojë numrin e duhur të ndihmësve ligjorë për çdo gjykatë apeli.

⁶¹Ekuivalentët për këshilltarë ligjorë/ndihmës ligjorë

⁶²Harta gjyqësore e gjykatave do të rishikohet në bazë në metodat e reja, duke shfrytëzuar kriteret e reja ligjore dhe parimet e parashikuara nga ligji për shpërndarjen territoriale të gjykatave, një kompetencë e përbashkët e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Ministrisë së Drejtësisë. Aktualisht, mbështetja në këtë aspekt konsiston në përcaktimin e metodave të reja bazuar në analizimin e treguesve të matshëm. Megjithatë, procesi i vendimmarrjes ka ndalur në pritje të ngritjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Sapo të ngrihen këto institucione, ato do të duhet të vendosin për hartën e re gjyqësore.

- b) çështjet penale (*zbatimi i penaliteteve, ankimimi përtej afateve të parashkrimit) shkallët e penaliteteve financiare, procedimet publike)*
- c) Në çështjet civile (*urdhër pagesat, ankandet e ndërtesave, procedurat e likuidimit, tatimet mbi kostot, procedurat e përbashkëta, zbatimet e vendimeve, dëgjimi i dëshmitarëve, bashkëpunimi gjyqësor, ekspertët e kontrollit, vënia në vend e të drejtave të kërkuësve)*

Në të njëjtën mënyrë, mund të përcaktohen më hollësisht detyrat e Këshilltarëve Ligjorë në Gjykatën e Lartë dhe Ndihmësit Gjyqësorë në gjykatat e apelit. Detyrat e mëposhtme mund të konsiderohen si bazë për diskutimet me të gjithë profesionistët gjyqësorë:

- Nënshkrimi i urdhrave të ekzekutimit dhe mbikëqyrja e zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë;
- Hartimi i raporteve para gjykimit dhe seancave;
- Përgatitja e mbledhjes shqyrtuese për gjyqtarin, përfshirë përgatitjen e propozimeve që gjyqtari mund të paraqesë në këtë mbledhje;
- Pjesëmarrja në mbledhjen shqyrtuese;
- Përgatitja e projekt-argumenteve;
- Përgatitja e projekt-vendimit;
- Kontaktimi me personelin ligjor që mbështet gjyqtarët e tjerë të trupës gjyqësore për bërjen e propozimeve për projekt-vendimin;
- Shqyrtimi i realizueshmërisë së çështjeve me vetëm një gjyqtar, ose duke i shpallur të papranueshme, ose duke i autorizuar për gjyq (e ngjashme me relatorin jogjyqtar të GjEDNj-së).⁶³

Në kontekstin e konsideratave më lart, ia vlen të thuhet se duket se ka konsensus dhe mirëkuptim të gjerë mes përfaqësuesve të kryetarëve të gjykatave dhe personelit ligjor në gjykatat shqiptare për t'iu caktuar më shumë detyra ligjore personelit jogjyqtar. Por, meqë këto detyra kanë natyrë ligjore, duhet t'iu besohen vetëm personelit ligjor, pra vetëm ndihmësve ligjorë, duke përjashtuar personelin menaxherial si kancelarët, të cilët janë të specializuar në menaxhimin e gjykatave dhe për këtë rekrutohen. Përshkrimi më i hollësishëm i detyrave aktuale mund të bëhet vetëm përmes dialogut me të gjitha kategoritë e personelit. Këto diskutime mund të rezultojnë në përshkrimi pune të hollësishme për secilin pozicion, me synim harmonizimin e praktikave. Standardizimi mund të arrihet edhe përmes publikimit të modeleve/shablloëve për tipologjitë më të zakonshme të akteve gjyqësore. Aktet normative që do të miratohen – përmes akteve nënligjore – mund të përcaktojnë formatin standard të opinionëve ligjore dhe shabllonet për projekt-vendimet (*nëse gjykohet e nevojshme për çështjet e thjeshta*). Gjithashtu, preferohet që të shmanget caktimi fragmentar i çështjeve nga një gjyqtar te tjetri. Kjo do të zgjidhte mospërputhjet dhe do të shmangte keqkuptimet dhe tensionet që mund të ndikojnë për keq te puna e gjykatës.

Në trajtimin e roleve të Ndihmësve Ligjorë dhe Këshilltarëve Ligjorë, fokusi është te pabarazitë në praktikën individuale, më shumë sesa te detyrat precize që i ngarkohen kategorive të personelit. Në gjykatat e apelit, këto mospërputhje mund të krijojnë keqkuptime dhe tensione që mund të ndikojnë për keq te puna e gjykatës. Në praktikën shqiptarë, ekzistojnë shqetësime nga Ndihmësit Ligjorë pranë gjykatave administrative për mungesën e vizibilitetit të punës së tyre, pasi emri i tyre nuk figuron në dosjen e çështjes. Kjo e vështirëson vlerësimin e punës së tyre dhe krijon problemin e llogaridhënies. Parimisht, llogaridhënia duhet të konsistojë në gjyqtarët që nënshkruajnë opinionet e hartuara prej ndihmësve gjyqësore menjëherë sapo i marrin. Modeli slloven është dhënë si shembull i mirë, Ndihmës Ligjorë përgatit shkresat, ia jep Gjyqtarit dhe i nënshkruajnë të dy. Meqë rregulloret nuk e parashikojnë nënshkrimin e opinionëve ligjore, ky aspekt mund të rregullohet me akte nënligjore.

⁶³ Neni 24 i KEDNJ-së

Në fund, është mbështetur ideja e harmonizimit të përgjithshëm të praktikave të Ndhmësve Gjyqësorë⁶⁴ me ato të Këshilltarit Gjyqësor në Gjykatën e Lartë, që duket se janë më uniforme dhe solide. Referuar praktikës së Këshilltarëve Ligjorë, sistemi i menaxhimit të çështjeve online e lejon integrimin e opinionit të Këshilltarëve Ligjorë, përmes një bashkëlidhjeje të vendimet e publikuara për çdo çështje. Ky u nënvizua si model i mirë për Ndhmësit Gjyqësorë në gjykatat e apelit, me qëllim rritjen e vizibilitetit dhe llogaridhënies së tyre. Në këtë drejtim, Ndhmësit Ligjorë duken të predispozuar që rregullat e praktikës në Gjykatën e Lartë të përdoren si bazë diskutimi për vetë detyrat e tyre.

V. Rekomandime

1. Rekomandime për rolin e kryetarëve

Rekomandimi 1: Nisur nga pushteti i kryetarit mbi vlerësimin e gjyqtarëve, mund të miratohen garanci ligjore dhe transparente për të garantuar që vlerësimi i gjyqtarëve të jetë i paanshëm dhe bazuar në fakte, në respektim të parimit të pavarësisë së brendshme të gjyqësorit.

Rekomandimi 2: Mund të miratohen udhëzime me përkufizime dhe kritere të paracaktuara për të lehtësuar detyrën e kryetarit në caktimin e çështjeve të gjyqtarët, në varësi të urgjencës, prioritetit, peshës dhe në pajtim me standardet e GjEDNj-së.⁶⁵

Rekomandimi 3: Kritere të paracaktuara duhet të vendosen nga kryetari për caktimin e çështjeve të këshilltarët ligjorë dhe ndihmësit ligjorë, duke pasur parasysh llojin e detyrave dhe natyrën e çështjeve.

Rekomandimi 4: Kryetarët nxiten të shfrytëzojnë mbledhjet me gjyqtarët për të promovuar sigurinë juridike dhe për të ndarë njohuritë mbi çështjet ligjorë dhe jurisprudencën e gjykatës. Nga këto mbledhjeve përfitohet edhe prej diskutimet mes kolegëve për çështjet, duke ftuar gjyqtarët të diskutojnë çështjet me kolegë ekspertë në “grupe cilësore”. Gjithashtu, kryetari mund të inkurajojë forume diskutimi të gjyqtarëve në lidhje me vendimet e tyre, me kolegë të tjerë, ose konsultime periodike me gjykatat më të larta. Objekt i diskutimeve duhet të jenë veçanërisht vendimet e rrëzuara ose të ndryshuara.

Rekomandimi 5: Kryetari mund të ndjekë një program trajnimi fillestar specifik dhe pastaj seminare periodike specifike për çështje që mund të shfaqen si nevoja për trajnim. Kryetarët e gjykatave të ndryshme duhet të mblidhen bashkë periodikisht që të shkëmbejnë idetë, të diskutojnë problematikat, të propozojnë seminare, tryeza të rrumbullakëta dhe vizita studimore për të përmirësuar njohuritë mbi

⁶⁴ Ndhmësit gjyqësorë në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë është termi i përdorur në Shqipëria si ekuivalent për Ndhmësit Ligjorë.

⁶⁵ Fleksibiliteti mund të ndihmojë në shmangien e vonesave të paarsyeshme që shkaktohen nga transferimi i gjyqtarëve (CEPEJ (2006)15, fq. 30). Rregullorja duhet të përcaktojë qartë çështjet prioritare bazuar në kriteret e përcaktuara nga GjEDNj (përfshirë gjendjen shëndetësore të aplikantit, ushtrimin e autoritetit prindëror, dhënien e pensionit ushqimor, moshën e aplikantit, çështjet e largimit nga puna dhe punësimin, kohëzgjatja e dënimit me burg që ka shlyer aplikanti, kapaciteti i gjendjes civile individuale, hetimi i ankesave për dhunim nga efektivet ligjzbatues, kompensimi i dëmeve që i janë shkaktuar aplikantit, etj). Shpërndarja e çështjeve nuk duhet të bazohet thjesht në parimin e numrit të barabartë të çështjeve ndërmjet gjyqtarëve, por bazuar në tipologjinë e çështjeve, aftësitë profesionale dhe specializimin e gjyqtarëve, ngarkesën e gjyqtarëve, urgjencës e çështjes, etj. Edhe roli i kancelarit duhet të përcaktohet në procedura, kur aplikohen kritere për përjashtimin e çështjeve nga caktimi me short, ose zëvendësimin e anëtarëve të trupës gjyqësore. Ngritja e një sistemi fleksibel të caktimit të çështjeve do të ndihmojë gjykatën të përshtatet më mirë me ndryshimet e paparashikuara të ngarkesës së punës. Në këtë drejtim, mund të përdoren “task forcat” apo “togat fluturuese” të gjyqtarëve. Për më tepër, është e mundur që të bëhen më fleksibel rregullat e juridiksionit territorial, por edhe kriteret e objektit dhe vlerës, për të pasur një caktim më efektiv të çështjeve dhe për të përbulluar ndryshimin e paparashikuar të ngarkesës.

menaxhimin e gjykatës. Rekomandohet që bazuar në temën që trajtohet, disa trajnime të zhvillohen jo vetëm me kryetarët, por edhe me nëpunës të tjerë të gjykatës (p.sh. kancelarët).⁶⁶

Rekomandimi 6: Roli i kryetarit të Gjykatës së Lartë si përfaqësues i gjyqësorit shqiptar duhet të nxitet më tej, për shembull, me dhënien e opinioneve në emër të gjyqësorit për zhvillimet strategjike dhe me përpilimin e legjislacionit që prek funksionimin e gjyqësorit, me konsultimin e tij në procesin e përgatitjes së buxhetit gjyqësor si edhe në përgatitjen e raporteve vjetore përkatëse për Kuvendin.

2. Rekomandimet për rolin e Kancelarëve

Rekomandimi 1: Politikat mund t'i delegojnë Kancelarit detyrën e organizimit të mbledhjeve me nëpunësit civilë gjyqësorë dhe punonjësit e gjykatës, me qëllim shkëmbimin periodik të informacionit që çon në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet departamenteve të gjykatës dhe personelit të gjykatës (gjyqtarët, nëpunësit civilë gjyqësorë, punonjësit e gjykatës).

Rekomandimi 2: Politikat mund t'i delegojnë Kancelarit detyrën e organizimit të mbledhjeve periodike me përdoruesit e gjykatës, meqë ai është aktor kyç në menaxhimin e shërbimeve të gjykatës. Politika duhet të përcaktojë përdoruesit relevantë (palët ndërgjyqëse, avokatët, prokurorët, përmbaruesit, përkthyesit, ekspertët, këshillin e mbrojtjes së fëmijëve, median) dhe organizimin e mbledhjeve periodike me ta, për përmirësimin e shërbimeve të gjykatës dhe diskutimin e prioriteteve të sistemit gjyqësor. Objektivat e këtyre mbledhjeve mund të jenë:

- Përmirësimi i aksesit të përdoruesve të gjykatës në legjislacion, vendimet e gjykatës dhe tekstet ligjore përmes faqeve të internetit falas dhe në gjuhën e pakicës;
- Garantimi i shpejtë i shërbimit të përkthimit;
- Informacioni i përditësuar për funksionimin e gjykatës;
- Hartimi i një karte me të drejtat dhe detyrimet e përdoruesve të gjykatës;
- Organizimi i sportelit të informacionit për vizitorët;
- Garantimi i transparencës së kostove/tarifave për proceset gjyqësore;
- Garantimi i trajtimit me dinjitet gjatë proceseve gjyqësore;
- Rritja e efikasitetit të procedurës së ankimit të publikut;
- Vlerësimi i besimit të publikut mbi baza periodike dhe publikimi i rezultateve;
- Dhënia e aksesit në informacion përdoruesve të gjykatës në lidhje me ecurinë e procesit, procedimet disiplinore, etj.

Rekomandimi 3: Politikat mund të adresojnë rolin potencial të Kancelarit në mbledhjen e informacionit dhe ndarjen e tij me aktorët e brendshëm dhe të jashtëm, përfshirë palët dhe publikun e gjerë. I gjithë informacioni i mbledhur mund të analizohet vazhdimisht dhe të përdoret për qëllime të monitorimit dhe përmirësimin të performancës së gjykatës në bazë të statistikave, ndërkohë që rezultatet mund të ndahen edhe me Ministrinë e Drejtësisë dhe KLD-në në raportet vjetore të gjykatave.

Rekomandimi 4: Politikat mund të adresojnë rolin e Kancelarit edhe për sa i përket sistemeve të menaxhimit të çështjeve. Kancelarët mund të mbledhin informacion për hapat më të rëndësishëm të procesit gjyqësor. Ata duhet të mbajnë shënim kohëzgjatjen mes këtyre hapave, në veçanti: (1) fillimi i procedimit; (2) njoftimi i procesit palës tjetër; (3) marrja e përgjigjes nga pala tjetër; (4) bërja e urdhrave proceduralë nga gjykata (4) dobia dhe koha mbahen konferencat përgatitore apo seancat

⁶⁶ Në këtë kontekst, trajnimet mund të jenë ose mbledhje mes kolegësh të kryetarëve të të gjitha gjykatave, ose mund të jenë mbledhje të kryetarëve me nëpunësit e tjerë të gjykatës (p.sh. kancelarët).

paraprake; (5) fillimi i fazës së gjykimit ⁶⁷(6) ekzistenca dhe kohëzgjatja e ekspertizës teknike; (7) kohëzgjatja dhe numri i seancave për themelin e secilës çështje; (8) përmbyllja e fazës së gjykimit; (9) vendimmarrja në shkallë të parë;⁶⁸ (10) shpallja dhe njoftimi i vendimit të shkallës së parë palëve; (11) fillimi i ankimit ligjor (apeli, etj.) dhe ndikimi të kohëzgjatja e procesit; (12) seancat dhe vendimet e apelit; (13) vendimet paraprake dhe urdhrat e gjykatave më të larta⁶⁹ (14) ecuria dhe rezultatet e procedimit të apelit dhe të tjera⁷⁰(15) faza të tjera të jashtëzakonshme dhe masat korigjuese;⁷¹ (16) efikasiteti i zbatimit të vendimeve gjyqësore.

3. Rekomandime për rolin e Ndhmësve Ligjorë⁷²

Rekomandimi 1: Të shihet mundësia për t'i dhënë më shumë vizibilitet punës së Ndhmësve Ligjorë, për shembull duke përmendur në vendim emrin e ndihmës ligjor që përgatiti projektin (draftin) ose duke bashkëfirmosur dokumentet administrative që kanë përgatitur (p.sh. shkresat për palët apo autoritetet) me gjyqtarin.

Rekomandimi 2: Të shihet mundësia e harmonizimit të detyrave që kryejnë aktualisht Ndhmës Ligjorë përmes publikimit të përshkrimeve të hollësishme të punës për secilin lloj pozicioni. Detyrat e mëposhtme mund të përfshihen:

- Nënshkrimi i urdhrave të ekzekutimit
- Hartimi i raporteve para gjykimit dhe seancave;
- Përgatitja e mbledhjes shqyrtuese për gjyqtarin, përfshirë përgatitjen e propozimeve që gjyqtari mund të paraqesë në këtë mbledhje;
- Pjesëmarrja në mbledhjen shqyrtuese;
- Përgatitja e projekt-argumenteve;
- Përgatitja e projekt-vendimit;
- Kontaktimi me personelin ligjor që mbështet gjyqtarët e tjerë të trupës gjyqësore për propozimet.

Rekomandimi 3: Të shihet mundësia e rishikimi të rregullit që parashikon se çdo gjyqtar të punojë me vetëm një Ndhmës Ligjor.

Rekomandimi 4: Të shihet mundësia e pasjes së ndihmësve ligjorë në gjykatat e shkallës së parë.

Rekomandimi 5: Të shihet mundësia e zbatimit të masave të avokuara nga Rekomandimi R(86)12 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës dhe Kartës së Bardhë të EUR-it për *Rechtspfleger* Evropian. Transferimi i pushtetit vendimmarrës të pavarur në fushat më poshtë mund të shihet si mundësi, nëse bie në fushën e veprimit të gjykatave:

- Çështjet familjare: kujdestaria, vendimet për gjendjen civile, administrimi i trustit të fëmijët
- Trashëgimia
- Shoqatat (themelimi i bizneseve?)

⁶⁷Seanca e parë verbale në themel

⁶⁸Vendimet paraprake, gjykimet e pjesëshme, gjykimet përfundimtare

⁶⁹p.sh. shpallja e vendimit ose zbardhja

⁷⁰p.sh. rrëzimi i vendimit ose kthimi për rigjykim

⁷¹p.sh. rihapja e çështjes ose shqyrtimit kushtetues

⁷² Termi Ndhmës Ligjor është termi evropian që përdoret këtu si ekuivalent *in abstracto* për Këshilltar Ligjor në Gjykatën e Lartë, Ndhmës Ligjor në Gjykatat e Apelit (juridiksioni i përgjithshëm/administrativ) dhe ndonjëherë dhe ndonjëherë merr nocionin e ndihmës ligjor që sugjerohet në të ardhmen për gjykatat e shkallës së parë.

- Procedurat e paaftësisë pagueuse
- Gjendja civile
- Urdhër-pagesat
- Ndihma ligjore
- Këshillimi ligjor
- Vendimet për tarifatat e gjykatës dhe avokatëve
- Caktimi i anëtarëve të arbitrazhit
- Vendimet në lidhje me raportet e ekspertëve (caktimi, monitorimi, pagimi i tarifave...)
- Vendimet për papranueshmëri
- Ekzekutimi
- Ndërmjetësimi

Shtojca 1 - Kuadri ligjor për rolin e Kryetarëve të Gjykatës

Procesi i përzgjedhjes dhe emërimit të Kryetarëve në Gjykatë: Sipas ligjit në formën aktuale,⁷³ Këshilli i Lartë Gjyqësor shpall avancën, përcakton nëse kandidatët përmbushin kriteret e rekrutimit për pozicionin e Kryetarit, vlerëson dhe rendit aplikantët bazuar në: a) rezultatet e dy vlerësimeve të mëparshme; b) përvojës profesionale relevante; c) vjetërsisë si magjistratë. Kryetari i gjykatës ose i prokurorisë me të drejtë rizgjedhjeje mund të aplikojë për mandat të dytë. Nuk kërkohet konsultimi i kolegëve gjatë përzgjedhjes së gjyqtarëve në gjykatat e shkallës së parë dhe në gjykatat e apelit.⁷⁴Një kandidat për kryetar ka të drejtë⁷⁵të ankimojë vendimin për caktimin në një detyrë, por ankimi nuk pezullon zbatimin e vendimit.

Aftësitë e kërkuara për t'u bërë Kryetar:Magjistrati mund të ngrihet në detyrë⁷⁶në pozicionin e kryetarit të gjykatës apo të prokurorisë së shkallës së parë apo apelit, nëse ka: shtatë vjet përvojë si magjistrat (4 vjet në të njëjtën shkallë, përfshirë përvojën si magjistrat i komanduar); aftësi organizative dhe drejtuese; nuk ka qenë anëtar i Këshillit në tre vitet e fundit. Më poshtë jepen kritere të tjera që mund të jenë relevante për ngritjen në detyrë të magjistratëve në pozicionin e kryetarit, si për shembull: a) përvojë si zv.kryetar, magjistrat ose anëtar i KLGj-së; b) inspektor në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; c) njohje të strukturave të caktuara organizative dhe qasjeve drejtuese. Arsimimi dhe trajnimi në menaxhim nuk është kërkesë eksplicite për t'u bërë kryetar.

Mandati: Referuar përvojës së vendeve evropiane, mandati i Kryetarit të gjykatës varion nga 2 në 7 vjet, pastaj kontrata mund të ripërtërihet me rikandidim. Në Shqipëri, mandati i Kryetarit është 3 vjet me vetëm një herë ripërtëritje të kontratës.

Shpërblimi:Në Shqipëri, magjistrati paguhet 10% shtesë mbi pagën fillestare bruto nëse marrin funksionin e Kryetarit të gjykatës apo të prokurorisë. Gjithashtu, magjistrati, kryetari i Gjykatës së Lartë dhe Prokurori i Përgjithshëm përfitojnë pension suplementar dhe përfitime të tjera. Paga dhe përfitimet e tjera të një magjistrati nuk mund të ulen.

Shkarkimi:Në Shqipëri, Kryetari i gjykatës mund të shkarkohet vetëm si rezultat i një shkeljeje disiplinore për përdorim të pasaktë të sistemit të menaxhimit të çështjeve, ose për mosnjoftim të KLGj-së kur ka konflikt interesi të një magjistrati.

Vlerësimi i punës së Kryetarëve:Ligji i ri në Shqipëri e bën Kryetarin e gjykatës objekt të vlerësimit të punës sipas aftësive drejtuese, organizative dhe komunikuese. Këshilli i Lartë Gjyqësor pastaj vendos se çfarë note t'i vëre vlerësimit, bazuar në vetëvlerësimin e Kryetarëve dhe në burime të tjera.

Mbarimi i mandatit të Kryetarëve:Ligji i ri në Shqipëri⁷⁷parashikon se mandati i Kryetarit mbaron menjëherë në momentin e skadimit të periudhës për të cilën është emëruar. Përndryshe, mbaron me mbarimin e statusit të tyre si magjistrat apo nëse aplikojnë për pozicionin e anëtarit të Këshillit.⁷⁸Vendimi i marrë nga KLGJ-ja në këtë drejtim supozon se Kryetari vazhdon funksionin si magjistrat në gjykatën apo prokurorinë përkatëse.

⁷³Neni 52 i Ligjit për statusin e gjyqtarëve.

⁷⁴Megjithatë, opinioni i tyre kërkohet me votë për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë gjatë mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve të gjykatës. Kjo vlen edhe për zv.Kryetarin në të gjitha nivelet e juridiksionit, i cili zgjidhet me votë gjatë mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve.

⁷⁵Sipas neneve 52 dhe 41/2-4 të Ligjit.

⁷⁶Sipas nenit 47 të Ligjit.

⁷⁷Neni 63 i Ligjit për statusin e gjyqtarëve.

⁷⁸Bazuar në arsyet e renditura në nenit 64⁷⁸të këtij Ligji.

Shtojca 2 - Kuadri ligjor për statusin dhe rolin e Kancelarëve

Përzgjedhja dhe emërimi: Kur ka vende vakante për kancelar, KLGj-ja është përgjegjëse për fillimin e procedurës së rekrutimit.⁷⁹ Kandidatët për kancelar zgjidhen nga Shkolla e Magjistraturës e cila vendos bazuar në: (1) renditjen e tyre në listën e kandidatëve (2) njohuritë e specializuara dhe përvojën (3) vitet e përvojës profesionale në sektorin e drejtësisë apo në pozicione drejtuese. Vendimi publikohet në faqen e internetit të KLGJ-së dhe kandidatët që nuk përzgjidhen kanë të drejtën e ankimit të vendimit të KLGJ-së në gjykatën përkatëse.

Aftësitë e kërkuara: Ligji/rregullorja e re nënvizon se kualifikimet e Kancelarëve duhet të jenë në përputhje me kërkesat e përgjithshme të pranimit në shërbim civil. Kandidatët duhet të plotësojnë fillimisht këto kritere: ⁸⁰(1) të kenë diplomë Master ose pasuniversitare në juridik ose ekonomik; (2) të kenë jo më pak se tetë vjet përvojë profesionale përfshirë tre vjet në pozicion drejtues ose të paktën pesë vjet në sistemin gjyqësor. Këshilli i Lartë Gjyqësor do të miratojë rregulla të hollësishme për kritere apo procedura shtesë në bazë të specifikimeve të punës së Kancelarit (neni 83).

Mandati: Këshilli i Ministrave është përgjegjës për përcaktimin e kohëzgjatjes së mandatit të Kancelarëve. Gjithashtu, Këshilli i Ministrave duhet të marrë vendime për rregullat e tjera që lidhen me kushtet e punës të Kancelarëve.⁸¹

Shpërblimi: Këshilli i Lartë Gjyqësor vendos me votë tre kategoritë e kancelarëve, në përputhje me ngarkesën e punës dhe shkallën e secilës gjykatë. Paga e shkallës më të lartë për një Kancelar është e barabartë me “pagën për funksion” të një drejtori të një drejtorie të përgjithshme; niveli mesatar është i barabartë me “pagën për funksion: të një drejtori të një drejtorie; ndërsa niveli më i ulët është i barabartë me “pagën për funksion” të një përgjegjësi sektori në nivel ministrie. Këshilli i Ministrave vendos rregulla më të hollësishme në lidhje me strukturën dhe progresionin e pagave, si dhe për pagesën për punën jashtë orarit dhe për rimbursimin e çdo kostoje tjetër që mund të lindë në kryerjen e detyrave profesionale jashtë ambientit të punës. Duhet të merren parasysh edhe praktikatat ekuivalente të shërbimit civil.

Shkarkimi: Këshilli i Lartë Gjyqësor është i autorizuar të vendosë sanksione disiplinore ndaj kancelarëve, kurse kryetarët e gjykatave janë përgjegjës për fillimin e procedimeve disiplinore ndaj kancelarëve (neni 69). Lista e shkeljeve të mundshme disiplinore për kancelarët bazohet tek ajo që përdoret për nëpunësit gjyqësorë civilë. Gjatë gjithë procedimit disiplinor, ata do të kenë të drejtë t'i kundërshtojnë pretendimet e ngritura, si dhe të drejtën e ankimit ndaj vendimit të marrë (neni 78). Vlerësimi i punës së kancelarëve: Performanca e kancelarëve do të vlerësohet periodikisht, së paku çdo dy vjet, duke filluar nga data kur ata kanë marrë detyrën. Ata do të vlerësohen në bazë të njohurive profesionale dhe aftësitë teknike, përkushtimit në punë, etikës në punë. Kryetari i Gjykatës do ta njoftojë kancelarin se kur ka nisur procesi i vlerësimit dhe do t'i kërkojë një vetëvlerësim.⁸² Kryetari përpilon raportin e vlerësimit dhe më pas Këshilli i Gjykatës vendos gradën. Kancelari mund të ankohet kundër këtij vendimi, në qoftë se merr një gradë/notë vlerësimi që është më pak se 'mirë'. Mbarimi i mandatit të kancelarëve: Këshilli i Lartë Gjyqësor do të jetë përgjegjës për ndërprerjen e mandatit të kancelarëve (neni 80).

⁷⁹ Neni.58

⁸⁰Nenet 55-56

⁸¹Kjo praktikë është e njëjtë në shumicën e vendeve evropiane, përveç Gjermanisë ku rolin e drejtuesit të gjykatës është emërim i përjetshëm, ndërsa në Itali mandati është katër vjet.

⁸² Do të përshkruajnë aktivitetet, do të identifikojnë nevojat për trajnim, do të sugjerojnë përmirësime të kushteve të punës dhe masa për zhvillimin e tyre profesional, do të identifikojnë dobësitë dhe pikat e forta në lidhje me çdo kriter vlerësimi.

Shtojca 3 - Kuadri ligjor për statusin dhe rolin e ndihmësve ligjorë

Përzgjedhja dhe emërimi: Këshilli i Lartë Gjyqësor është autoriteti përgjegjës për emërimin e këshilltarëve ligjorë dhe ndihmësve ligjorë bazuar në një listë të shkurtuar nga Shkolla e Magjistraturës. Ajo bazohet në çdo njohuri ose eksperiencë të specializuar që kandidati mund të ketë dhe në numrin e tyre të përvojës profesionale në sektorin e drejtësisë ose në pozita drejtuese. Këshilli i Lartë Gjyqësor do ta publikojë vendimin dhe rezultatet në faqen e tij zyrtare të internetit. Të gjithë kandidatët do të njoftohen për arsyen e vendimit të marrë. Kandidatët që nuk janë përzgjedhur do të kenë të drejtën e ankesës në gjykatën përkatëse.⁸³

Aftësitë që kërkohen për t'u bërë këshilltar ligjor: Provimi i pranimit për këshilltarë ligjorë ose ndihmës ligjorë në Shkollën e Magjistraturës kërkon që kandidatët t'i plotësojnë kërkesat e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil (neni 55).⁸⁴ Këshilltarët ligjorë jo-magjistratë do të emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor siç parashikohet nga dispozitat e këtij ligji. Kandidati duhet të plotësojë këto kritere: të kenë një diplomë Master ose pasuniversitare në drejtësi ose ekuivalente në përputhje me legjislacionin për arsimin e lartë; përvojë profesionale prej jo më pak se 10 vjet si zyrtar i lartë në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në administratën publike, profesionet ligjore, mësimdhënie në fakultetet juridike, ose në poste ekuivalente në sektorin privat ose në organizatat ndërkombëtare; njohuri të jurisprudencës së gjykatave kombëtare dhe ndërkombëtare; njohuri shumë të mirë të të paktën një gjuhe të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian; aftësi të shkruari dhe argumentimi ligjor; nuk duhet të jetë subjekt i asnjë mase disiplinore profesionale në fuqi; të ketë shkruar artikuj dhe të ketë pasur publikime shkencore në fushën e jurisprudencës (Neni 34)

Aftësitë që kërkohen për t'u bërë ndihmës ligjorë: Kandidatët për postin e ndihmës ligjor në Gjykatën e Apelit duhet të plotësojnë këto kritere: Master/diplomë pasuniversitare në drejtësi ose ekuivalentin në përputhje me legjislacionin e arsimit të lartë; përvojë profesionale prej jo më pak se pesë vjetësh, duke përfshirë të paktën tre vjet në një rol që lidhet me gjykatën (neni 56).

Mandati: Rregullorja nuk përcakton afatin mandat për nëpunësit gjyqësorë civilë, pasi është përgjegjësi e Këshillit të Ministrave për të përcaktuar kohëzgjatjen e kontratës së tyre dhe rregullore të tjera që lidhen me kushtet e tyre të punës.

Shpërblimi: Këshilli i Ministrave do të përcaktojë rregullat mbi strukturën dhe nivelet e pagave për nëpunësit gjyqësorë civilë. Këshilltarët ligjorë të zgjedhur nga lista e shkurtër e juristëve do të përfitojnë një rrogë që është e barabartë me "rrogën fillestare bruto" të gjyqtarit të gjykatës së shkallës së parë, por pa përfitime të tjera financiare.⁸⁵ Menjëherë pas emërimit, ndihmësit ligjorë do të përfitojnë nga një rrogë të barabartë me "pagën për funksionin" të një Drejtori Drejtorie në ministri.

Vlerësimi i performancës: Kryetari është autoriteti që propozon sanksione disiplinore për këshilltarët ligjorë dhe për ndihmësit ligjorë.⁸⁶ Këshilli i Lartë Gjyqësor vendos bazuar në këtë propozim dhe Këshilli i Gjykatës bën të njëjtën gjë për nëpunësit e tjerë civilë gjyqësorë.⁸⁷ Si nëpunësit civilë gjyqësorë të interesuar, ashtu edhe autoriteti përkatës do të kenë që të dy të drejtën e animimit ndaj çdo rezultati disiplinor (neni 78). Performanca e nëpunësve civilë gjyqësorë do të vlerësohet periodikisht të paktën një herë në dy vjet, bazuar në njohuritë e tyre profesionale dhe aftësitë teknike,

⁸³ Ligji "Për institucionet e qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë në Republikën e Shqipërisë"

⁸⁴ sipas Ligjit "Për shërbimin Civil" dhe kërkesave të veçanta të këtij ligji

⁸⁵ Në përputhje me Ligjin "Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"

⁸⁶ Kryetari i Gjykatës e mban të informuar stafin ligjor për fillimin e procesit të vlerësimit dhe u kërkon atyre një vetëvlerësim. Kryetari i gjykatës harton draft raportin e vlerësimit dhe i njofton ndihmësit ligjorë për të drejtën a) të aksesit në dosjen e vlerësimit dhe b) kundërshtimit të gjetjeve të raportit. Më pas, Këshilli i Gjykatës do të vendosë notën e vlerësimit⁸⁶ dhe do t'i informojë ndihmësit ligjorë.

⁸⁷ Dispozitat mbi rregullimet disiplinore përcaktuar në Ligjin/rregulloren "Për shërbimin Civil" do të aplikohen mutatis mutandis edhe nëpunësit civilë gjyqësorë, përveçse kur parashikohet ndryshe me këtë Ligj (neni 69).

përkushtimi dhe etika në punë. E drejta e ankimit mund të lindë vetëm nëse nota e vlerësimit është më pak se 'mirë'.

Fundi i mandatit të nëpunësve civilë gjyqësorë: Këshilli i Lartë Gjyqësor do të jetë përgjegjës për ndërprerjen e kontratave të shërbimit civil gjyqësor për këshilltarët ligjorë dhe ndihmësit ligjorë. Këshilli i Gjykatës do të ushtrojë të njëjtin funksion për nëpunësit e tjerë civilë gjyqësorë (neni 80).

Shtojca 4 - Tabela për rolin e Kryetarëve në kuadër të CCJE-së (Opinion 19)

Roli i Kryetarëve	Opinion Nr. 19 i CCJE-së	Rregullimi ligjor në Shqipëri	Praktikat evropiane
Përzgjedhja dhe emërimi	<p>Procedurat për emërimin e Kryetarëve dhe gjyqtarëve duhet të ndjekin të njëjtën rrugë.</p> <p>Do të ishte mirë që në proces të përfshiheshin edhe gjyqtarët përmes një forme votimi detyruese ose rekomanduese</p>	<p>Këshilli i Lartë Gjyqësor merret me:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) shpalljen e vendeve të lira 2) vlerësimin nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e ngritjes në detyrë për pozicionin e Kryetarit 3) Rendisin aplikantët sipas rezultateve: a) dy vlerësimet e mëparshme b) eksperiencia profesionale specifike; c) vjetërsia si magjistratë. <ul style="list-style-type: none"> – Garantohej e drejta e ankimit ndaj vendimit të emërimit në një post të caktuar – Gjykata kompetente do të vendosë brenda dy javësh nda data e paraqitjes së ankesës dhe vendimi i saj do të jetë i formës së prerë – Ankesa nuk pezullon zbatimin e vendimit – Kryetari i një gjykatës ose kreu i një prokurorie me të drejtë rizgjedhje mund të aplikojë për një mandat të dytë. – Për përzgjedhjen e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe për gjykatat e apelit nuk kërkohet mendimi i kolegëve të tyre gjyqtarë – Përrjashtim bëhet në zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë me votimin e gjyqtarëve në mbledhjen e përgjithshme të gjyqtarëve. <p>E njëjta gjë vlen edhe për Nënkryetarin në të gjitha nivelet e juridiksionit, i cili zgjidhet me votë në mbledhjen e përgjithshme të gjyqtarëve.</p>	<p>Nga praktikat evropiane,</p> <ul style="list-style-type: none"> – e drejta e ankimit ndaj këtyre vendimeve ka rezultuar e mundshme në teori, por shumë rrallë në praktikë – Përrjashtim bën Spanja, ku janë apeluar rreth 30% e "vendimeve" dhe Italia. – Në Norvegji, vetëm mund të kërkohet vetëm dëmshpërblim.

<p>Aftësitë</p>		<p>Ngritja në detyrën e Kryetarit: 1) Shtatë vjet përvojë si magjistrat (katër vjet në të njëjtin nivel, duke përfshirë përvojën si magjistrat i deleguar) 2) Nuk ka qenë anëtar i këshillit tre vitet e fundit. 3) Përvojë në pozicione drejtuese në administratën publike ose në administrimin e drejtësisë ose përvojë si anëtar i një Këshilli, mandati i të cilit ka përfunduar të paktën tre vjet më parë; 4) Njohje të mënyrave të ndryshme të organizimit dhe të stileve të menaxhimit, si magjistrat në skemën e lëvizshmërisë ose si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.</p>	<p>Shembuj në vendet evropiane:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në Norvegji dhe Spanjë aplikohet një lloj shkalle vjetërsie -në Gjermani aplikohet ekspertiza menaxheriale në pozicione të mëparshme, fleksibiliteti, aftësia e të qenit kritik ndaj vetes, aftësia për t'u përballur me kritika, -në Francë aplikohet njohja e legjislacionit, aftësia menaxheriale dhe aftësia për dialogim.
<p>Mandati</p>	<p>Gjetja e ekuilibrit të duhur për mandatin e Kryetarit,</p> <p>1) Perspektiva afatgjate: i jep mundësi Kryetarit të fitojë përvojë të mjaftueshme dhe të ofrojnë shërbime më të mira për përdoruesit e gjykatës</p> <p>2) Perspektiva afatshkurtër: është një mënyrë për të shmangur rutinën e që mund të dëmtojë idetë e reja.</p>	<p>Në Shqipëri, mandati i Kryetarit është 3 vjet me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.</p>	<p>Në vendet evropiane:</p> <p>Mandat i Kryetarëve të Gjykatës ndryshon në një gamë të gjerë:</p> <p>Nga 2 deri në 7(vjet), ku rizgjedhja është e mundur pas një konkurrimi të ri.</p>
<p>Vlerësimi i performancës</p>	<p>Performanca e Kryetarëve është objekt i vlerësimit në të njëjtën mënyrë si puna e gjyqtarëve të zakonshëm, duke</p>	<p>Kryetari i gjykatës është subjekt i vlerësimit të performancës sipas:</p> <p>1) aftësive drejtuese dhe organizative, 2) aftësitë e komunikimit.</p> <p>Këshilli i Lartë Gjyqësor vendos për gradën e</p>	

	respektuar të gjitha garancitë e nevojshme.	vlerësimit Vendimi bazohet në vetëvlerësimin e kryetarëve dhe në burime të tjera.	
Shpërblimi	Pagë shtesë për vendin e Kryetarit në varësi të shkallës së gjykatës dhe ndonjëherë madhësisë.	Magjistrati merr 10% pagë shtesë mbi pagën e tij fillestare bruto Përveç kësaj, Kryetari i Gjykatës së Lartë dhe Prokurori i Përgjithshëm do të marrin një pension shtetëror plotësues dhe përfitime të tjera. Paga dhe përfitimet e tjera të një magjistrati nuk mund të ulen.	
Heqja nga detyra	Garancitë mos <i>mosheqjen nga detyra</i> duhet të zbatohen në mënyrë të barabartë për gjyqtarin dhe për Kryetarin e Gjykatës. Kryetari mund të hiqet vetëm pas një procedure disiplinore për performancë të dobët menaxheriale, si p.sh. në Turqi, Hungari, dhe Hollandë.	Kryetari i gjykatës mund të hiqet si rrjedhojë e një mase disiplinore: 1) në rast të mosgarantimit të përdorimit ose shfrytëzimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve, 2) për mosnjohim të KLGJ-së kur ka një rast mospërputhshmërie të një magjistrati me detyrën.	
Fundi i Mandatit	Heqja e Kryetarit para mbarimit të mandatit Përjashtim nga rregulli i përgjithshëm Procedurat duhet të jenë transparente duke përjashtuar çdo rrezik të ndikimit politik që mund të vijë nga pjesëmarrja në	Mandati i Kryetarit përfundon menjëherë pas përfundimit të periudhës për të cilën ai/ajo është emëruar. Përndryshe, 1) mandati i Kryetarit përfundon me përfundimin e statusi i tij si magjistrat 2) ose me aplikimin e tij për pozicionin e anëtarit të Këshillit KLGJ-ja është autoriteti kompetent për të vendosur për këtë. Kryetari vazhdon të funksionojë si magjistrat në gjykatën ose prokurorinë përkatëse.	

	këtë proces e pushtetit ekzekutiv, si për shembull e Ministrisë së Drejtësisë.		
--	--	--	--